



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit me Karakter Profesional 2-vjeçar në
“Dizajn dhe Zhvillim Software”
i Institucionit të Arsimit të Lartë
Universitetit “Metropolitan Tirana”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


1. Prof. Asoc. Ariana Bejleri

2. Dr. Valma Prifti

Tetor/2022

Për programin e studimit me Karakter Profesional 2-vjeçar në “Dizajn dhe Zhvillim Software”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Metropolitan Tirana
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierisë Elektrike dhe Elektronike (Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Diplomë Profesionale në Dizajn dhe Zhvillim Software
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 205, datë 03.07.2020
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMT u riorganizua dhe me Urdhrin nr. 611, date 28.09.2018, te ministrit përgjegjës për arsimin
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Diplomë Profesionale
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5 (pesë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	v.a 2020-2021 – 5 PAE/3 PAK v.a 2021-2022 – 8 PAE/4 PAK
18	Numri i studentëve:	v.a 2020-2021 – 5 studentë v.a 2021-2022 – 5 studentë
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës;

Universiteti “Metropolitan Tirana” është institucion i arsimit të lartë, licencuar me Vendim Nr. 357, datë 12.05.2010 të Këshillit të Ministrave me statusin e Shkollës Private të Arsimit të Lartë “Universiteti Metropolitan Tirana”. Sipas këtij vendimi, institucioni organizohet në dy fakultete: Fakulteti i Inxhinierisë dhe Shkencave të Aplikuara dhe Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës.

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 për arsimin e lartë, UMT është riorganizuar me Urdhrin nr. 611, datë 28.09.2018, të ministrit përgjegjës për arsimin, dhe ka miratuar Statutin e tij, tashmë me statusin si Universiteti “Metropolitan Tirana”, dhe me VBA nr.45, datë 05.07.2019 është akredituar si universitet (pas dy akreditimeve institucionale me status të shkollës së lartë).

Universiteti “Metropolitan Tirana” përbëhet nga 3 fakultete dhe secili prej tyre ka në përbërje tre njësi bazë, të organizuara si më poshtë:

1. “Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT” i përbërë nga
 - Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike;
 - Departamenti i Inxhinierisë Elektrike dhe Elektronike;
 - Qendra Kërkimore Shkencore.
2. “Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës” i përbërë nga:
 - Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit;
 - Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës;
 - Departamenti i Shkencave të Natyrës.
3. Fakulteti i Ekonomisë.
 - Departamenti i Shkencave Administrative;
 - Departamenti Financë Bankë;
 - Departamenti i Informatikës Ekonomike.

Struktura institucionale (akademike) organizohet në njësi administrative dhe kërkimi, që mbështeten nga strukturat administrative. Në aktin themelor të institucionit, Statutin e Universitetit Metropolitan Tirana, dhe nga Ministria përgjegjëse për arsimin, në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 (Urdhri i miratimit të statutit sipas ligjit 80/2015), përcaktohen qartë funksionet e organeve më të larta kolegjiale të autoriteteve drejtuese të institucionit: Bordit të Administrimit, Senatit Akademik, Komisioneve të Përhershme, Këshillit të Etikës, Këshillit të Sigurimit të Cilësisë, Rektorit, Administratorit, dekanëve dhe përgjegjësve të departamenteve.

Programi i studimit profesional në “Dizajn dhe Zhvillim Software” ka një kohëzgjatje normale studimi prej 2 (dy) vite akademike dhe 120 ECTS. Programi është licencuar për herë të parë me urdher nr. 194 të datës 03/07/2020 për vitin akademik 2020-2021. Ky është akreditimi i parë që programi i studimit i nënshtrohet. Ky program studimi ofrohet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL” dhe akteve nënligjore në funksion të tij.

Procesi i vlerësimit të jashtëm të cilësisë në kuadër të akreditimit të programit 2-vjeçar profesional në Dizajn dhe Zhvillim Software (PrDZhS), konsiderohet mjaft i rëndësishëm për institucionin dhe njësitë përbërëse të tij, si proces në vijimësi i akreditimeve institucionale të UMT dhe të programeve të studimit që ofron ky institucion.




Ky proces nuk shihet vetëm si plotësim i detyrimit për akreditim të programit, por dhe për shkallën e përmbushjes së standardeve të cilësisë për këtë lloj programi nga FSHKIT, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit dhe institucionit në tërësi.

Vlerësimi i jashtëm i programit u realizua në përputhje me procedurat e miratuara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit të Lartë të Shqipërisë dhe bazuar në manualin “Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit” (www.ascal.al) të kësaj agjencie dhe standardet dhe kriteret e programeve profesionale, pjesë e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë.

Duke qenë një program i ri studimi i ofruar nga UMT, vitet e para karakterizohen me numra jo shumë të lartë studentësh. Si rrjedhojë, statistikave të zhvilluar brenda grupit të studentëve mund të mos japin rezultate lehtësisht të interpretueshme.

“Universiteti Metropolitan Tirana” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 27/09/2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 170/13 Prot, datë 28/09/2022. “Universiteti Metropolitan Tirana” përcjell në ASCAL me anë të shkresës Nr. 157/1 Prot., datë 03/10/2022, “Kthim përgjigje mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm”, ku shprehet se nuk ka komente. Në këtë mënyrë Draft-RVJ merr formën e Raportit final.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Grupi i vlerësimit të jashtëm për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm (RVJ), është ngritur nga ASCAL. Anëtarët e GVJ janë zgjedhur në bazë të kompetencave të tyre profesionale, paanshmërisë, mundësisë për të mbledhur dhe aksesuar e përpunuar informacionin e nevojshëm për kryerjen e vlerësimit, në marrjen në konsideratë të mendimeve të tyre. GVJ përbëhet nga 2 anëtarë dhe është themeluar vetëm për qëllim të raportit të vlerësimit të jashtëm të programit PrDZhS.


Procesi vlerësimit të jashtëm të cilësisë për programin PrDZhS është realizuar në bashkëpunim me ASCAL me koordinatorë teknike të ASCAL, Msc. Arjana Alija.

Aktivitete e kryera në kuadër të hartimit të Raportit të Vlerësimit të Jashtëm të PrDZhS nga GVJ janë zhvilluar në bazë të afateve kohore të përcaktuara më parë.

Gjatë kryerjes së procesit të vlerësimit, GVJ është udhëhequr nga ruajtja e etikës profesionale dhe zbatimi i kuadrit ligjor mbi aksesin në të dhënat personale dhe konfidencialitetin e tyre.

Në hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm të PrDZhS është synuar të japë një tablo e qartë gjithëpërfshirëse për programin e studimit, duke evidentuar njëkohësisht cilat janë pikat e forta të këtij programi studimi dhe ato që duhen përmirësuar në të ardhmen.

Procedura e vlerësimit të jashtëm, është parë si një proces dinamik vlerësimi dhe diskutimi për të paraqitur realitetin dhe njëkohësisht të evidentohen dhe adresohen për zgjidhje problematikat e mundshme. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, janë të angazhuar në këtë proces që konsiderohet mjaft i rëndësishëm për të kuptuar gjendjen aktuale, në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të cilësisë në FSHKIT dhe UMT. Sugjerimet dhe rekomandimet që do të jepen nga ne janë bërë me bindjen se do t'i vlejnjë institucionit në rritjen e cilësisë dhe performancës në të ardhmen.



Vlerësimi i programi të studimit me karakter profesional 2-vjeçar në “Dizajn dhe Zhvillim Software”.

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Bazuar tek RVB dhe nga pyetjet gjatë vizitës në institucion vumë re që departamenti harton programet e studimit duke pasur si bazë strategjinë e UMT, po ashtu edhe statutin e tij. Për t'u hartuar programi kombinohen lëndë me karakter teorik dhe praktik. Këto lëndë hartohen dhe miratohen në nivel Departamenti, Dekanati dhe përcillen për miratim në Senat. Senati është organ kolegjal akademik që monitoron të gjitha aspektet akademike të institucionit. Vëmë re që programi i studimit me karakter profesional “Dizajn dhe Zhvillim Software” është në linjë me synimet dhe misionin e institucionit ashtu siç paraqitet në statutin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit. Ky program ka në fokus krijimin, zhvillimin, transmetimin e dijeve dhe pajisjen e studentëve me aftësi dhe kompetencat e nevojshme për t'u bërë profesionistë në fushën e zhvillimit të software-it.</p> <p>(Neni 4 : Në Aneksin Nr. 01. Statuti i UMTsë, Neni Nr. 64, pika 7 : Në Aneksin Nr. 01. Statuti i UMTsë, Neni Nr. 4 : Në Aneksin Nr. 02. Rregullore e UMTsë, Vizioni, Misioni, Objektivat Strategjike: Në Aneksin Nr. 03. Strategjia e Zhvillimit të Institucionit. Aneksi Nr. 1: Statuti i UMTsë; Aneksi Nr. 3: Strategjia e Zhvillimit të Institucionit, Shënimet nga përgjigjet e pyetjeve gjatë vizitës.)</p>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>Në statutin dhe rregulloren e UMT-së përcaktohen drejtimit prioritar akademike në fushat e shkencave të aplikuara, inxhinierisë, ekonomisë, etj. Fusha e programit me karakter profesional 2-vjeçar “Dizajn dhe Zhvillim Software” përfshihet në shkencat e sakta dhe në veçanti në fushat inxhinierike në përputhje me Statuti UMT-se dhe Rregulloren e UMT-se. Struktura e programit të studimit është në përputhje me strukturën e programeve të ciklit të parë (sipas ligjeve në fuqi dhe të pasqyruara në Statuti UMT – (Nenet 64, 67, 68, 69,71).</p> <p>(Neni Nr. 4, pika a, c, d : Në Aneksin Nr. 01. Statuti i UMTsë, Nenet 64, 67, 68, 69, 71, të Aneksit Nr. 1: Statuti i UMT-së, Neni Nr. 4 : Në Aneksin Nr. 02. Rregullore e UMTsë.)</p>
Kriteri 3. Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.	<p>Bazuar tek të dhënat e përgjithshme mbi programin e studimit, si edhe referuar planit mësimor dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion vumë re që programi me karakter profesional “Dizajn dhe Zhvillim Software” ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike (njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe IT). Departamenti ofron gjithashtu dy programe studimi të nivel bachelor si “Inxhinieri Kompjuterike” dhe “Inxhinieri Software”. Këto</p>

	<p>programe studimi janë në linjë mes tyre si dhe drejtimin e njësisë bazë në veçanti dhe institucionit në tërësi.</p> <p>Vizioni është që programi të zhvillohet në vazhdimësi, me synimin për përgatitjen cilësore të specialistëve në fushat e teknologjisë në përgjithësi dhe atë të zhvillimit të software në veçanti. Programi synon formimin e shprehive të veçanta në llojshmëri të gjerë në fushën e zhvillimit software duke e njohur studentin me disa nga gjuhët më të përdoruar të programimit, si dhe platformat e zhvillimit. Megjithëse programi i studimit në fjalë është një program i ri, UMT ka një eksperiencë të gjatë në fushën e teknologjisë duke ofruar programe të të gjitha niveleve në fushën e inxhinierisë kompjuterike dhe inxhinierisë software.</p> <p>(Aneksi Nr. 41: Të dhëna të përgjithshme mbi programin e studimit, Aneksi Nr. 09: Plani mësimor)</p>
<p>Kriteri 4. Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>Bazuar te dokumentacioni i dosjes, RVB, dokumentat mbi studimin e tregut të punës, kompanive me të cilat UMT ka marrëveshje bashkëpunimi, si edhe listës së universiteteve me të cilat UMT bashkëpunon, si edhe informacionit gjatë pyetjeve në takimin në institucion, GVJ konstaton se UMT përpara hapjes së programit të studimit, kryen studime të tregut të punës, studime lokale dhe ndërkombëtare, në mënyrë që të projektojë perspektivat e punësimit të të diplomuarve dhe ti lidhë me kërkesat e tregut. Kërkimi mbi tregun e punës përfshin gjithashtu kërkesat e punëdhënësve si për aftësitë teknike ashtu edhe për njohuritë akademike nga studentët. FSHKIT kryen studim të vazhdueshëm të tregut të punës, me qëllim përditësimin e materialeve didaktike për programin me karakter profesional në fjalë. Vihet re që është bërë evidentimi i vazhdueshëm i të dhënave të publikuara nga INSAT si edhe evidencime në vazhdimësi nga kompanitë e reja dhe nevojat e tyre. Në nivel Fakulteti, vëmë re që ka marrëdhënie me kompani të ndryshme në kuadrin e praktikave mësimore jo vetëm në kuadrin e programit të studimit në fjalë por edhe për programe studimi të ngjashme. Gjithashtu, institucioni ka marrëdhënie të ndryshme bashkëpunimi me institucione arsimore në kuadrin e mobilitetit.</p> <p>(Aneksi Nr. 11: Studimi i tregut të punës; Aneksi 12. Lista e kompanive me të cilët institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi; Aneksi Nr. 13: Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuadër të shkëmbimit/mobilitetit)</p>
<p>Kriteri 5. Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Gjate vizitës dhe nga dokumentacioni i dosjes vumë re se për të gjitha programet e studimit, në formë periodike, UMT zhvillon analizën e tregut të punës si dhe ecurinë e programit të studimit për të vlerësuar ecurinë e këtij të fundit si dhe hapat që mund të jenë të nevojshëm për tu ndërmarrë për garantimin e cilësisë, apo ndryshimet përkatëse që të lidhen me punësimin e studentëve.</p> <p>Për programin me karakter profesional “Dizajn dhe Zhvillim Software”, i cili është një program i ri studimi, UMT ka bere analizën e tregut për hapjen e programit.</p> <p>GVJ vuri re edhe gjatë pyetjeve gjatë vizitës në institucion që në</p>

	<p>vazhdim, pasi të diplomohen brezat e parë, UMT do të shikojë punësimin e studentëve për vlerësuar arritjen e objektivave të programit të studimit.</p> <p>(Aneksi Nr. 11: Studimi i tregut të punës)</p>		
<p>Kriteri 6. Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>GVJ vuri re gjatë vizitës në institucion, si edhe nga shqyrtimi i dosjes që prej vitesh, UMT ka marrëdhënie bashkëpunimi me disa kompani në fushën e teknologjisë dhe me gjerë, në kuadrin e programeve të studimit që ajo ofron si “Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike” dhe “Bachelor në Inxhinieri Software”, kompetencat e të cilave afroh me ato të programit me karakter profesional 2-vjeçar “Dizajn dhe Zhvillim Software”. Vumë re që janë bërë vlerësime të vazhdueshme gjatë kësaj eksperience të gjatë bashkëpunimi në lidhje me kërkesat e tregut të punës, për tu marrë parasysh përputhshmëria e aftësive të fituara nga studentët në përfundim të programit, me kompetencat që ka nevojë tregu, etj. Vumë re që risi për programin PrDZhS është edhe projekti i fituar nga UMT në kuadrin e Regional Challenge Fund, i cili parashikon rritjen e punësimit të studentëve në kompanitë që janë partner të këtij projekti duke i garantuar studentëve akses të sigurt në tregun e punës. Studentët sipas këtij projekti do të shkojnë në zyrat e partnerit dhe duke qenë praktikantë do të mësojnë në vendin e punës, pranë kompanisë ku do të kryejnë intershipin. Ata do të marrin pjesë në projekte reale që duhen bërë për kompaninë.</p> <p>(Aneksi Nr. 49: Projektet CTBE-TMD)</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Mbas vizitës në institucion dhe shqyrtimit të dosjes dhe bazuar te RVB, vëmë re që Institucioni ka organigramën e tij të mirë strukturuar për sa i përket organizimit akademik (pjesa akademike përbëhet nga organet dhe autoritetet drejtuese akademike, njësite kryesore dhe njësitë bazë (departamentet dhe qendrat kërkimore shkencore) dhe organizimit administrativ (pjesa administrative, e cila përbëhet nga organet dhe autoritetet drejtuese administrative si edhe njësitë e shërbimit. Organigrama e UMT, me njësitë përbërëse të saj, e cila shpreh lidhjet dhe varësitë ndërmjet tyre, është miratuar nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Bazuar në statutin e institucionit, rregulloren e institucionit, departamenti si njësi bazë është përgjegjës për mbarëvajtjen e programit të studimit, përgjegjësi i njësisë bazë kërkon rishikime dhe përmirësime të programeve të studimit, të kurrikulave në bazë të nevojave dhe treguesve akademikë. Gjithashtu vëmë re që në mbështetje akademike vijnë Fakulteti (si</p>

	<p>njësi kryesore) dhe Senati si organi më i lartë për çështjet akademike. Në mbështetje organizative vijnë edhe të gjitha njësitë e tjera administrative si Zyra e Pranimit, Sekretaria Mësimore, Zyra e Projekteve dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, etj., të cilat në mënyrë të vazhdueshme bashkë-rendojnë veprimtaritë e tyre për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe shkencor në mbështetje të programit të studimit. Për të monitoruar dhe siguruar cilësinë në institucion, realizohet edhe pyetësi i studentëve, me indikatorë të përgjithshëm dhe specifikë të vlerësimit dhe monitorimit, për të bërë një analizë të vazhdueshme të punës. Po ashtu vëmë re që mbi vlerësimin e procesit mësimor realizohet edhe pyetësi drejtuar stafit akademik, që ka për qëllim mbledhjen e opinioneve dhe vlerësimeve të pedagogëve për anë të ndryshme të procesit mësimor.</p> <p>(Pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB, Aneksi Nr. 51: Raport i vlerësimit të procesit të mësimdhënies semestri I rë 2021 – 2022; Aneksi Nr. 52: Raport NJSBC stafi akademik sem. II 2020-2021, Aneksi Nr. 04 - Organigrama UMT, Aneks Nr. 01 - Statuti UMT, Aneksi Nr. 02 - Rregullore e Brendshme e UMT).</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Vëmë re gjatë shqyrtimit të dosjes, dhe bazuar në RVB, që për të realizuar objektivat në lidhje me procesin mësimor, institucioni ka marrëdhënie të vazhdueshme me institucione të tjera akademike dhe në fokus të këtij bashkëpunimi është shkëmbimi në eksperiencë, shkëmbimi i stafit, organizimi i aktiviteteve të përbashkëta, etj. Vëmë re, bazuar te lista e kompanive me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi, që institucioni mban marrëdhënie të vazhdueshme me kompanitë nga ku informohet mbi nevojat e tregut për teknologjitë e reja të cilat mund të integrohen apo harmonizohen me mësimdhënien. Në veçanti, në kuadrin e programit të studimit PrDZHS, UMT është fitues i projektit “Cooperative Training for Better Employees in Tourism Management and Digitalization (CTBE-TMD)” i cili do të mundësojë studentët të zhvillojnë një periudhë praktike prej 3 muajsh e gjysëm në një nga kompanitë partnere të projektit. Studentët sipas këtij projekti do të shkojnë në zyrat e partnerit dhe duke qenë praktikantë do të mësojnë në vendin e punës. Po kështu GVJ konstatoi që një fokus i veçantë në UMT i kushtohet ndërkombëtarizimit edhe me anë të shkëmbimeve Erasmus+ për stafin akademik dhe studentët. Lëvizshmëria e studenteve dhe stafit është një pjesë e rëndësishme e ndërkombëtarizimit, për shkak të vlerës së madhe nga perspektiva e grantmarrësit, por edhe për shkak të ndikimit që ka në vendosjen e bashkëpunimit të mëtejshëm midis institucioneve.</p> <p>(Aneksi Nr. 13: Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuadër të shkëmbimit/mobilitetit, Aneksi Nr. 49: Projekti CTBE-TMD, Aneksi 12: Lista e kompanive me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi, Pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB).</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Bazuar në pyetjet gjatë takimit në institucion, dhe në dokumentat e dosjes GVJ vuri re që si procedurë në përfundim të vitit akademik, departamenti bën një vlerësim të marrëdhënieve me kompanivë me të cilat ka një marrëveshje. Një nga aspektet kryesore të këtij vlerësimi është produktiviteti i praktikave mësimore që studentët zhvillojnë në semestrin e fundit të programit mësimor. Studenti, pasi ka përfunduar praktikës mësimore, përcjell në departament një përmbledhje të</p>

	<p>aktivitetit të zhvilluar i cili vlerësohet nga një komision i ngritur për vlerësimin e këtij procesi. Gjatë këtyre intervistave, vlerësohen përfitimet reale të studentëve gjatë periudhës së zhvillimit të praktikës dhe angazhimin e kompanisë në këtë drejtim. Zhvillimi i praktikës pranë një kompanie duhet të miratohet paraprakisht nga përgjegjësi i departamentit. Duke qenë ky brezi i parë i diplomimit, studentët janë aktualisht duke zhvilluar praktikat mësimore pranë kompanive dhe nuk ka studentë të ta kenë përmbyllur akoma këtë detyrim për bërë vlerësimet përkatëse. Kur të përmbyllen do jenë pjesë e raportit vjetor të aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar, për të evidentuar përfitimet nga këto bashkëpunime.</p> <p>(Aneksi Nr. 14: Formulari i pranimit të praktikës mësimore, Aneksi 12: Lista e kompanive me të cilët institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi, Pyetjet gjatë takimit në institucion, Aneks Nr. 38: Raport vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Vume re gjatë shqyrtimit të dosjes dhe pyetjeve gjatë vizitës në institucion që institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me kompani vendase për zhvillimin e praktikave mësimore që studentët duhet të kryejnë për të gjitha programet e studimit. Nëse me një kompani nuk ka një marrëveshje institucionale, departamenti i paraqet kërkesë një kompanie duke përcjellë në kërkesë emrin e studentit që dëshiron të zhvillojë praktikën mësimore</p> <p>Në veçanti, për programin e studimit PrDZhS, në kuadër të projektit CTBE-TMD, studentët e këtij programi studimi, zhvillojnë praktikat e tyre pranë kompanisë: Albanian Business Partner dhe SoftMogul. Ky projekt është ndërtuar në partneritet me pesë kompani shqiptare. Kohëzgjatja e trajnimit të parë do të jetë 3.5 muaj. Dy javet e para studentet do të marrin mësimet teorike nga trajnerët e kompanisë. Ata mësojnë konceptet bazë që do të përdorin gjatë trajnimit të tyre praktik. Nisur edhe nga numri i reduktuar aktual të studentëve, nuk janë përfshirë kompani të tjera. Megjithatë, UMT ka marrëveshje me disa kompani në kuadrin e programeve bachelor dhe master që ofrohen pranë këtij institucioni. Studentët do të mësojnë si të përmirësohen duke testuar njohuritë në situata reale.</p> <p>(Aneksi Nr. 49: Projekti CTBE-TMD, Aneksi 12. Lista e kompanive me të cilët institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi, Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dosjes, RVB, si edhe bazuar në pyetjet gjatë vizitës në institucion, konstatoi që institucioni u mundëson studentëve të diplomuar të ndjekin lëndë specifike të ofruara nga programet e studimit për të thelluar njohuritë e tyre që mund të nevojiten në tregun e punës. UMT u ka garantuar studentëve të këtij programi studimi zhvillimin e praktikave në kompani me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, dhe me perspektivën për tu punësuar.</p> <p>Institucioni, përveç mbështetjes së punësimit të studentëve nëpër kompani të ndryshme nëpërmjet realizimit të praktikave mësimore, ka në fokus edhe mundësinë e vetë-punësimit me anë të krijimit të sipërmarrjeve të reja. UMT ka themeluar inkubatorin e parë “on-campus” i quajtur “Metropolitan Incubator” i cili mbështet idetë e</p>

	<p>biznesit të paraqitura nga studentët. Krahas ekspertizës teknike nga mentorë me përvojë në fushën e teknologjisë, grupet e punës gëzojnë edhe këshillimin e ekspertëve në fushën e biznesit (kryesisht nga kolegë të Fakultetit të Ekonomisë).</p> <p>Gjithashtu u vu re gjatë pyetjeve nga GVJ në institucion që UMT organizon në mënyrë për përvitshme konkursin “StartUp City” (https://umt.edu.al/start-up-city). Ky konkurs mundëson nëpërmjet çmimeve të ndryshme, që të mbështeten ide inovative financiarisht apo edhe me mbështetjen e drejtpërdrejtë të inkubatorit.</p> <p>(Aneksi 12. Lista e kompanive me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi, Pyetjet gjatë vizitës në institucion, Aneksi Nr. 49: Projekti CTBE-TMD).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>GVJ konstatoi nga dosja dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që programit i studimit ka një kohëzgjatje prej 2 vitesh (e ndarë në katër semestra). Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe çdo lëndë ka një numër të caktuar kreditesh sipas sistemit ECTS në përputhje me legjislacionin në fuqi që pasqyrohet në statutin e UMT. Një pamje më gjithëpërfshirëse paraqitet në planin mësimor të programit të studimit ku paraqiten edhe lëndët së bashku me sasinë e krediteve përkatëse në total për çdo lëndë. Po kështu në dokumentin me të dhënat e përgjithshme të programit të studimit shohim kohëzgjatjen e programit të studimit, si edhe Kreditet (ECTS) në total, gjithashtu edhe ndarjen e krediteve në vite akademike dhe semestra. Një krediti të studimeve universitare i korrespondojnë 25 ore mësimore pune të studentit. Gjithashtu vëmë re edhe ndarjen e krediteve në përqindje sipas tipit të veprimtarisë.</p> <p>Programi i studimit me karakter profesional, “Dizajn dhe Zhvillim Software” është organizuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të lartë LAL 80/2015 dhe me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. Ky program studimi është organizuar në lëndë dhe module të shprehura në kredite (ECTS) dhe orë, me një total prej 120 ECTS (60 ECTS/vit) dhe me kohëzgjatje normale 2 vjeçare, organizuar në 4 semestra, me kohë të plotë. Programi i studimit ofron një gamë njohurish në kategoritë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • e lëndëve të formimit të përgjithshëm (A) – 18 ECTS (që përbëjnë 15 % të programit), • e lëndëve karakterizuese profesionale (B) – 66 ECTS (55%), • e lëndëve bashkëvepruese /integruese të fushës (C) – 12 ECTS (10 %), • e lëndëve të aftësisimit informatik dhe praktikës profesionale (D) – 18 ECTS (15 %) dhe

	<p>punimi i temës së diplomës (E) – 6 ECTS (5 %).</p> <p>(Aneksi Nr. 01: Statuti UMT – Neni 67, Aneksi Nr. 09: Plani mësimor, Aneksi Nr. 41: Të dhënat e përgjithshme të programit të studimit, Pyetjet në takimin në institucion.)</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfitim të njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dosjes, RVB dhe pyetjeve gjatë vizitës në institucion konstatoi që programi i studimit ka për qëllim formimin e studentit në fushën e teknologjisë së informacionit në përgjithësi dhe në atë të inxhinierisë software në veçanti, specializuar në zhvillimin e aplikacioneve kompjuterike (software). Ky program synon të thellojë njohuritë e studentëve, duke mundësuar përgatitje të avancuar të tyre për formimin e kompetencave dhe aftësive. Vëmë re që në veprimtarinë e tij ky program ka për objektive të japë pjesëmarrësve aftësitë e plotat të arsyetimit dhe trajtimit bashkëkohor të çështjeve në fushën e inxhinierisë software, duke marrë një kombinim të njohurive profesionale në këtë fushë. Me përdorimin e teknologjisë në fusha gjithmonë e më të shumta, studenti është potencial për të shërbyer në një numër të shumtë profesionale. Ai mund të fokusohet nga një anë në ato pozicione që kanë një lidhje të drejtpërdrejtë si p.sh.: rrjetat kompjuterike, kompanitë e shërbimeve informatike, ISP (Internet Service Provider), kompanitë e zhvillimit të software (Software House), etj; Gjithashtu edhe në kompani apo institucione që ofrojnë shërbime dhe përdorin pajisje apo sisteme numerike si p.sh.: bankat, industria e rëndë dhe e lehtë, institucionet shtetërore, spitalet, etj. Ky program studimi me karakter profesional, “Dizajn dhe Zhvillim Software”, ka një fokus më të ngushtë se “teknologjia e informacionit”, në përgjithësi duke u përqendruar në pjesën e kodimit. Por nga ana tjetër pjesa e zhvillimit software shtrihet në një hapësirë mjaft të gjerë. Duke futur këtu edhe pjesën industriale, pajisjet e të cilës komandohet nga aplikacionet përkatëse, etj.</p> <p>(Aneksi Nr. 06: Rregullore e Programit të Studimit, Pyetjet në takimin në institucion)</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dosjes, RVB dhe pyetjeve gjatë vizitës në institucion konstatoi që parimi themelor është përcjellja e njohurive bazë që i mundëson studentit një zhvillim më të thelluar, në vijim tek kompetencat e avancuara. Programi i studimit ka si qëllim njohjen e studentit me konceptet bazë të programimit si dhe me njohjen e disa platformave që kanë marrë një përdorim të gjerë në industri. Vëmë re që në veprimtarinë e tij ky program ka për objektive të japë pjesëmarrësve aftësitë e plotat të arsyetimit dhe trajtimit bashkëkohor të çështjeve në fushën e inxhinierisë software, duke marrë një kombinim të njohurive profesionale në këtë fushë. GVJ konstatoi edhe nga plani mësimor, që pjesa më e madhe e lëndëve shoqërohet me orë laboratorike që cilat e formojnë studentin me kompetencat praktike të nevojshme për të hyrë në tregun e punës. Një nga aspektet kryesore të këtij vlerësimi është produktiviteti i praktikave mësimore që studentët zhvillojnë në semestrin e fundit të programit mësimor.</p> <p>(Aneksi Nr. 06: Rregullore e Programit të Studimit; Aneksi Nr. 09: Plani mësimor, Pyetjet në takimin në institucion)</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit me</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dosjes, RVB dhe pyetjeve gjatë vizitës në</p>

<p>karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>institucion konstatoi që programi i studimit me karakter profesional, “Dizajn dhe Zhvillim Software”, ka si synim përcjelljen e kompetencave në fushën e zhvillimit software duke e njohur me gjuhët e ndryshme të programimit dhe platformat e përdorura për zhvillim. Gjithashtu, GVJ vuri re që gjatë programit të studimit, studentët marrin lëndë të cilat i ndihmojnë në dizajnimin dhe organizimin e zhvillimit të software-reve në përgjithësi (lëndë si “Hyrje në Inxhinieri Software”) si dhe koncepte manaxheriale (lëndë si “Ekonomia dhe Inovacioni”) për menaxhimin e një grupi pune apo sipërmarrje. Këto bëjnë që të zhvillohen kompetencat për menaxhimin apo mbikëqyrjen në kuadrin e gjithë veprimtarive profesionale ku ai do të punësohet, dhe bën që të menaxhohen këto situata me orientimin e duhur.</p> <p>(Aneksi Nr. 09: Plani Mësimor, Pyetjet në takimin në institucion)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentat e dosjes, RVB dhe pyetjeve gjatë vizitës në institucion, konstatoi që UMT, është institucion i akredituar me Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr.45, date 05.07.2019 pas riorganizimit të UMT si universitet. Në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe IT/ Departamentin Inxhinierise Kompjuterike, nga tabelat vumë re që kishte për vitin akademik 2021-2022 në total 17 persona si staf (16 personel akademik dhe 1 ndihmës akademik. PAE ishin 8 (1 Prof Dr, 1 Prof Asoc, 2 Dr, dhe 4 MSc), dhe PAK ishin 8 (1 Prof Asoc, 4 Dr, 1 Dr në Proc dhe 2 MSc. Ndërsa për vitin akademik 2020-2021 në total janë 21 persona si staf (19 personel akademik dhe 2 ndihmës akademik. PAE ishin 9 (2 Prof Dr, 3 Dr, dhe 4 MSc), dhe PAK ishin 10 (2 Prof Dr, 1 Prof. Asoc, 5 Dr, dhe 2 MSc. Ndërsa stafi akademik në programin e studimit profesional në dizajn dhe zhvillim software për vitin akademik 2020-2021 kishte 5 PAE (1 Prof Dr, 2 Dr, dhe 2 MSc), dhe 3 PAK ishin (1 Prof Dr, 1 Prof Asoc, 1 Dr.), 8 në total. Ndërsa për vitin akademik 2021-2022 kishte 8 PAE (2 Dr, 6 MSc), dhe 4 PAK (1 Prof Asoc, 2 Dr, 1 MSc). 12 në total.. Numri i personelit akademik efektiv në funksion të realizimit të këtij programi studimi sipas normës së parashikuar nga aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi.</p> <p>Personeli akademik i përfshirë në këtë program studimi ka një përvojë akademike të konsiderueshme në mesimdhënie dhe në fushën e kërkimit shkencor. Personeli akademik me kohë të pjeshme që është thirrur për të mbuluar ngarkesën mësimore është përzgjedhur, kryesisht me tituj e grada shkencore dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore.</p> <p>(Tabela Përmbledhëse PSWE, 1 dhe 2 mbi stafin akademik të departamentit, dhe 6 dhe 7 mbi stafin akademik për programin e studimit. Aneksi Nr. 15: VBA për Akreditimin Institucional të UMT, Pyetjet në takimin në institucion).</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dosjes, informacionit të paraqitur në rregulloren e programit të studimit, RVB dhe pyetjeve gjatë vizitës në institucion, konstatoi që Programi i studimit, ka objektiva të qarta rreth formimit profesional që duhet të arrijë studenti në përfundim të ciklit të studimit. Këto objektiva janë harmonizuar në strukturën e programit mësimor dhe të detajuara në silabuset e lëndëve përkatëse.</p> <p>Nisur nga arkitektura me tre nivele e aplikacione software, studenti njihet me menaxhimin e të dhënave (sistemet e menaxhimit të databazave), me programimin e logjikës së biznesit (programim procedural, programim i</p>

	orientuar në objekte, programim i skripteve) si dhe atë të ndërfaqeve grafike (web, mobile dhe desktop).			
	(Aneksi Nr. 09: Plani mësimor; Aneksi Nr. 10: Silabuset e lëndëve, Pyetjet në takimin në institucion)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
				X

II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit me karakter profesional, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dosjes, RVB dhe pyetjeve gjatë vizitës në institucion konstatoi që programi i studimit me karakter profesional, “Dizajn dhe Zhvillim Software”, i ofruar nga FSHKIT, ka objektiva të përcaktuara mirë për formimin e studenteve me njohuri teorike dhe praktike, aftësi dhe kompetenca profesionale në përputhje me: profilin e programit; me nivelin e studimeve ku ofrohen; me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Programi dy vjeçar në “Dizajn dhe Zhvillim Software” ka si qëllim dhe objektiv formues, formimin e profesionistëve me kompetenca profesionale në sektorin e teknologjisë së informacionit të përgjithësi dhe të zhvillimit të aplikacioneve software në veçanti. Vëmë re që ky program ka për objektiv tu japë pjesëmarrësve aftësitë e plota të arsyetimit dhe trajtimit bashkëkohor të çështjeve në fushën e inxhinierisë software, duke marrë një kombinim të njohurive profesionale në këtë fushë. Një pikë tjetër që vumë re në misionin e tij është marrja e dijes për përdorim të pavarur nëpërmjet njohjes së metodave, instrumenteve e teknikave të kërkimit. Me përdorimin e teknologjisë në fusha gjithmonë e më të shumta, studenti është potencial për ti shërbyer në shumë profesione. Programi i studimit ofron njohuri në fushën e arkitekturës kompjuterike, rrjetave, bazë të dhënash, programim procedural, programim i orientuar në objekte, programim në web, programim mobile, etj. Në përfundim të programit, i diplomuari, do të pajiset me kompetenca profesionale për</p>


	<p>të operuar në sektorin e teknologjisë dhe të zhvillimit software.</p> <p>Vumë re që në faqen web të universitetit ka informacion, për një audiencë të gjerë. Aty është edhe plani mësimor. UMT ofron në mënyrë të vazhdueshme sesione informuese për kandidatët e rinj që interesohen për të ndjekur studimet pranë UMT duke përcjellë të gjitha informacionet e nevojshme jo vetëm për programin e studimit por edhe mundësitë e aksesit në treg. Lidhur me mundësitë e punësimit institucioni, në vijimësi, ka kontakte me kompani kryesisht private që operojnë në fushën e teknologjisë në veçanti me ata që kategorizohen si “software house”. Nisur edhe nga kërkesa e lartë në tregun rajonal dhe botëror, po ashtu edhe këtu, kompanitë kanë një nevojë të vazhdueshme për të rinj që janë të aftë të zhvillojnë aplikacione software apo që mirëmbajnë sisteme kompjuterike.</p> <p>(Aneksi Nr. 06: Rregullore e programit të studimit, ; Aneksi Nr. 10: Silabuset e lëndëve, Aneksi 12. Lista e kompanive me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi, Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dosjes, bazuar në RVB dhe pas pyetjeve gjatë vizitës në institucion konstatoi që programet e studimit janë të organizuar në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH” dhe me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të Lartë”, i ndryshuar. Këtu përfshihet edhe programi me karakter profesional “Dizajn dhe Zhvillim Software”.</p> <p>Programi i studimit “Dizajn dhe Zhvillim Software” ka një kohëzgjatje 2 vjeçare. Ai është i organizuar në 2 vite akademike dhe në 4 semestra. Gjatë një semestri studenti fiton 30 kredite ECTS me një total prej 120 ECTS në përfundim të ciklit të studimit. Ngarkesa mësimore mesatare e studentit është 20 orë në javë.</p> <p>Plani mësimor pasqyron strukturën akademike të programit të studimit duke dhënë detaje si:</p> <p>Emërtimin e lëndës, Numrin e ECTS, Shpërndarjen e ECTS në ngarkese: leksione, seminar, laborator, detyrë kursi, shpërndarjen e orëve sipas ECTS.</p> <p>Tipologjinë e lëndë (sipas emërtimit A-E)</p> <p>Programi i studimit respekton ndarjen në kategori të lëndëve si dhe përqindjen përkatëse:</p> <p>A: formim i përgjithshëm të fushës A (15%), B: karakterizuese profesionale te fushës (55 %) C: integruese te fushës (10 %) D: aftësimin informatik dhe praktikës profesionale të fushës D (15%) E: provim final (5 %).</p> <p>Çdo lëndë e planit mësimor detajohet me anë të dokumentit përkatës, të silabusit, i cili përmban të dhëna si:</p> <p>Emërtimi i lëndëve, semestrin; Numri i krediteve për çdo modul dhe ngarkesa e orëve (leksione seminare, laboratorë); Tipologjia e lëndës/modulit (bazë, karakterizuese, etj.)</p>

	<p>Objektivat formuese ,Temat sipas javëve, Literaturën e detyrueshme dhe atë të rekomanduar.</p> <p>Detyrimet sipas moduleve (seminare, ushtrime, punime, detyra kursi, projekte, praktikë);</p> <p>Mënyra e kontrollit të dijeve të çdo moduli;</p> <p>Silabuset e lëndëve janë në përputhje me elementët që parashikohen në shtojcën e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 i ndryshuar.</p> <p>GVJ vuri re që studentëve u vihet në dispozicion përmbajtja e plotë e programit të studimit gjatë javës së parë të fillimit të lëndës. Gjatë javës së parë të mësimit, studentët e rinj marrin pjesë në sesionet e orientimit ku njihen me programin e studimit, stafin akademik, këshilltarin akademik, përfaqësues të njësisve administrative si dhe me mbështetjen/informacionin që mund të japin çdo njësi.</p> <p>(Aneksi Nr. 09 - Plani mësimor, Aneksi Nr. 27 – Formatet e Syllabuseve, Pyetjet gjatë vizitës në institucion, Aneksi Nr. 10 – Syllabuset e lëndeve)</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dosjes, bazuar në RVB dhe pas pyetjeve gjatë vizitës në institucion konstatoi që programet e studimit janë të organizuar në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH” dhe me VKM Nr. 41, date 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të Lartë”, i ndryshuar. Këtu përfshihet edhe programi me karakter profesional “Dizajn dhe Zhvillim Software”.</p> <p>Programi i studimit “Dizajn dhe Zhvillim Software” ka një kohëzgjatje 2 vjeçare. Ai është i organizuar në 2 vite akademike dhe në 4 semestra. Gjatë një semestri studenti fiton 30 kredite ECTS me një total prej 120 ECTS në përfundim të ciklit të studimit. Ngarkesa mësimore mesatare e studentit është 20 orë në javë.</p> <p>Plani mësimor pasqyron strukturën akademike të programit të studimit duke dhënë detaje si:</p> <p>Emërtimin e lëndës/modulit</p> <p>Numrin e ECTS</p> <p>Shpërndarjen e ECTS në ngarkesë: leksione, seminar, laborator, detyrë kursi.</p> <p>Shpërndarjen e orëve sipas ECTS.</p> <p>Tipologjinë e lëndë (sipas emërtimit A-E).</p> <p>Programi i studimit respekton ndarjen në kategori të lëndëve si dhe përqindjen përkatëse:</p> <p>A: formim i përgjithshëm të fushës A (15%),</p> <p>B: karakterizuese profesionale te fushës (55 %)</p> <p>C: integruese te fushës (10 %)</p> <p>D: aftësimin informatik dhe praktikes profesionale të fushës D (15%)</p> <p>E: provim final (5 %).</p> <p>Çdo lëndë e planit mësimor detajohet me anë të dokumentit përkatës, të silabusit, i cili përmban të dhëna si:</p> <p>Emërtimin e moduleve të grupuara dhe të renditura në semestra;</p> <p>Numri i krediteve për çdo modul dhe ngarkesa e orëve (leksione seminare, laboratorë);</p> <p>Tipologjia e lëndës/modulit (bazë, karakterizuese, etj.)</p> <p>Objektivat formuese</p>



	<p>Temat sipas javëve Literaturën e detyrueshme dhe atë të rekomanduar Detyrimet sipas moduleve (seminare, ushtrime, punime, detyra kursi, projekte, praktikë); Mënyra e kontrollit të dijeve të çdo moduli; Silabuset e lëndëve janë në përputhje me elementët që parashikohen në shtojcën e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 i ndryshuar. GVJ vuri re që studentëve u vihet në dispozicion përmbajtja e plotë e programit të studimit gjatë javës së parë të fillimit të lëndës/modulit. Gjatë javës së parë të mësimit, studentët e rinj marrin pjesë në sesionet e orientimit ku njihen me programin e studimit, stafin akademik, këshilltarin akademik, përfaqësues të njësive administrative si dhe me mbështetjen/informacionin që mund të japin çdo njësi.</p> <p>(Aneksi Nr. 09 - Plani mësimor, Aneksi Nr. 27 – Formatet e Syllabuseve, Pyetjet gjatë vizitës në institucion, Aneksi Nr. 10 – Syllabuset e lëndëve, RVB)</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikatat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dosjes, bazuar në RVB dhe pas pyetjeve gjatë vizitës në institucion konstatoi që programet e studimit janë të organizuar në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH” dhe me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të Lartë”, i ndryshuar. Këtu përfshihet edhe programi me karakter profesional “Dizajn dhe Zhvillim Software”. Programi i studimit “Dizajn dhe Zhvillim Software” ka një kohëzgjatje 2 vjeçare. Ai është i organizuar në 2 vite akademike dhe në 4 semestra. Gjatë një semestri studenti fiton 30 kredite ECTS me një total prej 120 ECTS në përfundim të ciklit të studimit. Ngarkesa mësimore mesatare e studentit është 20 orë në javë.</p> <p>Plani mësimor pasqyron strukturën akademike të programit të studimit duke dhënë detaje si:</p> <p>Emërtimin e lëndës/modulit Numrin e ECTS Shpërndarjen e ECTS në ngarkese: leksione, seminar, laborator, detyrë kursi Shpërndarjen e orëve sipas ECTS. Tipologjinë e lëndë (sipas emërimit A-E) Programi i studimit respekton ndarjen në kategori të lëndëve si dhe përqindjen përkatëse: A: formim i përgjithshëm të fushës A (15%), B: karakterizuese profesionale te fushës (55 %) C: integruese te fushës (10 %) D: aftësimin informatik dhe praktikës profesionale të fushës D (15%) E: provim final (5 %).</p> <p>Çdo lëndë e planit mësimor detajohet me anë të dokumentit përkatës, te silabusit, i cili përmban të dhëna si: Emërtimin e lëndës, titullarin; Numri i krediteve për çdo lëndë dhe ngarkesen e orëve (leksione seminare, laboratorë); Tipologjia e lëndës (bazë, e detyrueshme, karakterizuese, etj.) Objektivat formuese, Temat sipas javëve, Literaturën e detyrueshme</p>

	<p>dhe atë të rekomanduar, Detyrimet sipas moduleve (seminare, ushtrime, punime, detyra kursi, projekte, praktikë); Mënyra e kontrollit të dijeve të çdo moduli; Permbledhje dhe rezultatet e te nxenit, Konceptet themelore, etj. Silabuset e lëndëve janë në përputhje me elementët që parashikohen në shtojcën e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 i ndryshuar. GVJ vuri re që studentëve u vihet në dispozicion përmbajtja e plotë e programit të studimit gjatë javës së parë të fillimit të lëndës/modulit. Gjatë javës së parë të mësimit, studentët e rinj marrin pjesë në sesionet e orientimit ku njihen me programin e studimit, stafin akademik, këshilltarin akademik, përfaqësues të njësive administrative si dhe me mbështetjen/informacionin që mund të japin çdo njësi.</p> <p>(Aneksi Nr. 09 - Plani mësimor, Aneksi Nr. 27 – Formatet e Syllabuseve, Pyetjet gjatë vizitës në institucion, Aneksi Nr. 10 – Syllabuset e lëndëve; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB).</p>
<p>Kriteri 5. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p>	<p>GVJ konstatoi se plani mësimor i programit me karakter profesional “Dizajn dhe Zhvillim Software” është hartuar duke analizuar me kujdes nevojat e tregut të punës si dhe nevojat konkrete të kompanive që operojnë.</p> <p>UMT me qëllim zhvillimin e procesit të studimit dhe kërkimit në standartet më të mira kombëtare e ndërkombëtare është pajisur me laboratorë e ambiente multifunkionale të aksesueshme për të gjitha grupet e interesit, si psh: Laboratori i Informatikës, Laboratori Multifunksional, Laboratori i Matjeve elektrike dhe elektronike, Laboratori i automatikes dhe FPGA, etj.</p> <p>Objekti i programit të studimit është të përcjellë konceptet themelore në fushën e zhvillimit të aplikacioneve software dhe jo njohjen me gjuhë programimi apo platforma të caktuara. Për shembull, në trajtimin e koncepteve të gjuhëve të orientuara në objekte, labororet mund të zhvillohet në Java ose në C# pa cenuar strukturën dhe objektivat e lëndës. Lektorët janë të lirë që për pjesën praktike të përshtatin përdorimin e gjuhëve apo platformave specifike sipas nevojave aktuale të tregut të punës apo interesit të grupit të studentëve.</p> <p>Po kështu praktika synon për përvetësim efektiv të njohurive teknike dhe etike të profesionit.</p> <p>Vume re që programi i studimit reflekton zhvillimet e reja në teknologjinë e informacionit si dhe zhvillimet e aplikacioneve software.</p> <p>(Aneksi Nr. 09 - Plani mësimor, Aneksi Nr. 27 – Formatet e Syllabuseve, Pyetjet gjatë vizitës në institucion, Aneksi Nr. 32 – Lista e laboratorëve në funksion të programit të studimit; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB).</p>
<p>Kriteri 6. Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>	<p>GVJ konstatoi që plani mësimor parashikon dhënien e njohurive bazë mbi konceptet e programimit dhe zhvillimit software si dhe një larmishmëri konceptesh të nevojshme në mbështetje të kësaj të fundit në drejtime të ndryshme të teknologjisë së informacionit.</p>



	<p>Vume re që lëndët teknike zhvillohen në laborator ku merren njohuritë e mjaftueshme praktike që do i mundësojnë student aftësitë e nevojshme për tu integruar në tregun e punës. Lëndë si: “Programim Web”, “Programim Mobile”, “Programim i Gjuhëve Visuale” dhe “Grafika Kompjuterike” janë disa nga lëndët që sot kanë një kërkesë të theksuar në tregun e punës.</p> <p>Po kështu praktika synon për përvetësim efektiv të njohurive teknike dhe etike të profesionit. Kur parashikohet si pjesë e planeve mësimore Praktika ka një numër të caktuar kreditesh, dhe zhvillohet në institucione sipas profilit të studentit dhe nën drejtimin e pedagogut udhëheqës të caktuar nga departamenti përkatës.</p> <p>Struktura përgjegjëse për ndjekjen e praktikës profesionale janë:</p> <p>Autoritetet drejtuese te UMT</p> <p>Komisioni i vlerësimit të praktikës</p> <p>Pedagogu udhëheqës</p> <p>Mentori profesionist</p> <p>Gjithashtu vumë re në rregulloren e programit të studimit që vlerësimi në një lëndë mund të bëhet: me provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar, me detyra kursi ose projekte, si edhe i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi, ku secila ka peshën e vet në strukturë.</p> <p>(Aneksi Nr. 19: Orari mësimor, Aneksi Nr.09 - Plani mësimor, Aneksi Nr. 45 – Rregullore e praktikave mësimore, Aneksi Nr. 10 – Syllabuset e lëndëve, Aneksi Nr. 06 – Rregullore e programit të studimit; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	GVJ, bazuar te dokumentacioni dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion, konstatoi që ngarkesa mësimore në programin e studimit është shpërndarë në përputhje me VKM nr.41, Dt.24.01.2018, i ndryshuar, duke ruajtur ngarkesën ditore, javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, detyre kursi etj. Lëndët dhe raporti i tyre (ngarkesa në orë/kredite) janë përcaktuar në përputhje me këto akte ligjore dhe nënligjore duke synuar njëkohësisht përafrimin me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në vitin e parë në planin mësimor të programit PrDZHS realizohen nga pesë lëndë për cdo semester me nga 6


	<p>kredite. Në vitin e dytë në planin mësimor të programit PrDZhS realizohen pesë lëndë semestrin e parë me nga 6 kredite dhe semestrin e dytë dy lëndë me 6 kredite, plus praktiken dhe projektin individual, me nga 12 kredite dhe 6 kredite përkatesisht.</p> <p>Ngarkesa e programit të studimit PrDZhS përmban 120 kredite evropiane (ECTS) dhe zhvillohet në dy vite me nga 60 ECTS për secilin vit akademik. Për çdo ECTS ofrohen mesatarisht 10 orës mësimi në auditor. Ora mësimore zgjat 60 minuta (50 minuta mësim dhe 10 minuta pushim ndërmjet orëve). Ngarkesa ditore është mesatarisht 4 orë në javë ndërsa ngarkesa javore është mesatarisht 20 orë mësimi.</p> <p>(Aneksi Nr. 19: Orari mësimor; Aneksi Nr. 9: Plani mësimor; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB).</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ, bazuar te dokumentacioni dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion, konstatoi që ngarkesa mësimore në programin e studimit është shpërndarë në përputhje me VKM nr.41, Dt.24.01.2018, i ndryshuar, duke ruajtur ngarkesën ditore, javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, detyre kursi etj.</p> <p>Lëndët dhe raporti i tyre (ngarkesa në orë/kredite) janë përcaktuar në përputhje me këto akte ligjore dhe nënligjore duke synuar njëkohësisht përafrimin me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në vitin e parë në planin mësimor të programit PrDZhS realizohen nga pesë lëndë për cdo semester me nga 6 kredite. Në vitin e dytë në planin mësimor të programit PrDZhS realizohen pesë lëndë semestrin e parë me nga 6 kredite dhe semestrin e dytë dy lëndë me 6 kredite, plus praktikën dhe projektin individual, me nga 12 kredite dhe 6 kredite përkatesisht.</p> <p>Ngarkesa e programit të studimit PrDZhS përmban 120 kredite evropiane (ECTS) dhe zhvillohet në dy vite me nga 60 ECTS për secilin vit akademik. Për çdo ECTS ofrohen mesatarisht 10 orës mësimi në auditor. Ora mësimore zgjat 60 minuta (50 minuta mësim dhe 10 minuta pushim ndërmjet orëve). Ngarkesa ditore është mesatarisht 4 orë në javë ndërsa ngarkesa javore është mesatarisht 20 orë mësimi.</p> <p>Programi i studimit ka një ekuilibër dijes teorike dhe praktike. Ai jep elementë të kulturës së përgjithshme dhe zgjeron elementet e dijes profesionale. Integrimin sa më i mirë i studentëve në tregun e punës bëhet duke kombinuar pjesën teorike me anën praktike. Kjo mundëson rritjen e njohurive dhe kompetencave të nevojshme të studentëve. Vume re që për të përshtatur sa më mirë programin me tregun e punës, UMT-ja koordinon me FSHKIT-në dhe DIK-në vazhdimisht dhe vëzhgon ndryshimet në kërkesat për aftësi e njohuri të pozicioneve të punës në organizata/biznese dhe i reflekton ndryshimet e nevojshme brenda lëndëve perkatese.</p> <p>(Aneksi Nr. 9: Plani mësimor; Aneksi Nr. 19: Orari mësimor; Aneksi Nr. 11: Studimi i Tregut të Punës; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB).</p>

<p>Kriteri 3. Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.</p>	<p>GVJ, bazuar te dokumentacioni dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion, konstatoi që syllabuset e programit të studimit përmbajnë të gjitha elementet sipas shtojcës përkatëse të VKM nr. 41, Dt.24.01.2018, i ndryshuar, duke filluar me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxëniet, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura.</p> <p>U vu re nga GVJ që pjesa e literaturës në çdo silabus përbëhet nga literaturë bazë të detyrueshme dhe literaturë ndihmëse. Përditësimi i përmbajtjes së silabuseve koordinohet nën drejtimin e departamentit që ofron programin e studimit i cili njëkohësisht monitoron realizimin e lëndës/modulit në përputhje me silabusin e miratuar. Botimet e reja të fushave përkatëse të studimit integrohen me koncepte të lëndëve përkatëse, ku njohuritë e përvetësuara u paraqiten studenteve për diskutim.</p> <p>Literatura e përdorur gjatë procesit mësimor ka si qëllim të jetë një literaturë elitare pavarësisht dimensionit kohë. Për sa i përket teksteve me karakter teknik i kushtohet kujdes jo vetëm ri-botimeve të mëvonshme por edhe mundësive që të jenë të aksesueshme nga studentët. U kushtohet vëmendje mundësisë së literaturës online dhe të aksesueshme nën qasjen “Creative Commons”, ose nën variantet e saj. Në rast se kjo nuk është e mundur, atëherë lektori mund të këshillojë botimin e parafundit i cili mund të gjendet me kosto më të reduktuara pranë distributorëve si Amazon ose AbeBooks.</p> <p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që në programin e studimit PrDZhS, në vitin e parë në planin mësimor të programit PrDZhS realizohen nga pesë lëndë për cdo semestër me nga 6 kredite. Në vitin e dytë në planin mësimor të programit PrDZhS realizohen pesë lëndë semestrin e parë me nga 6 kredite dhe semestrin e dytë dy lëndë me 6 kredite, plus praktikën dhe projektin individual, me nga 12 kredite dhe 6 kredite përkatësisht.</p> <p>Secila lëndë është e vlerësuar në kredite (ECTS) sipas tipit të veprimtarisë (A-E) dhe orë mësimore (leksione, seminare, detyra, laborator, praktikë.). Në këtë formë është mundësuar realizimi i objektivave të programit qoftë në formim të studentëve, por edhe në aftësimin profesional. U vu re gjatë pyetjeve të vizitës në institucion që DIK-i kryen në mënyrë periodike analiza dhe studime mbi rezultatet e pritshme të studentëve dhe realizimin e objektivave të programit.</p> <p>(Aneksi Nr. 9: Plani mësimor; Aneksi Nr. 19: Orari mësimor; Aneksi Nr. 10: Silabuset e lëndëve; pyetjet gjatë vizitës në institucion; RVB).</p>
<p>Kriteri 4. Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion.</p>	<p>GVJ, bazuar te dokumentacioni dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion, konstatoi që siç pasqyrohet edhe në orarin mësimor, të gjitha lëndët me karakter teknik zhvillohen pjesërisht (50%) ose tërësisht (100%) në laborator. Praktika profesionale bashkë me punimin e projektit të diplomës</p>

	<p>përbëjnë 18 ECTS nga 120 ECTS të programit të studimit.</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit PrDZhS, reflekton në mënyrë të detajuar një sërë informacionesh për emërtimin e lëndëve, numrin e krediteve për secilën lëndë apo modul, semestri në të cilin zhvillohet lënda, orëve për leksione, seminare, detyra, projekte, laborator, praktikë. Më pas në syllabuse jepen detyrimet e lëndës (leksione, seminare, detyra kursi, projekt kursi, laboratore), jepen komponentët e vlerësimit të studentit, mënyra e vlerësimit të dijeve, ngarkesën mësimore, orët që kryhen në auditor, etj.</p> <p>(Aneksi Nr. 19: Orari mësimor; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB; Aneksi Nr. 9: Plani mësimor; Aneksi Nr. 10: Silabuset e lëndëve).</p>		
<p>Kriteri 5. Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GVJ, bazuar te dokumentacioni dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion, konstatoi që ndarja sipas veprimtarive formuese, në programin e studimit PrDZhS është bërë sipas akteve ligjore në fuqi. Ky organizim mundëson për programin arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> <p>Lëndët e ofruara nga programi i studimit PrDZhS janë të ndara sipas tipologjive që përcakton ligji dhe kanë raportet si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> A. Disiplina të formimit të përgjithshëm – 18 ECTS (15%) B. Disiplina të formimit karakterizues të programit – 66 ECTS (55%) C. Disiplina ndersiplinore formuese të ngjashme ose/dhe integruese 12 ECTS (10%) D. Veprimtari formuese për njohje të gjuhës së huaj, aftësi informatike, praktikë laboratorike. – 12 ECTS (10%) E. Diploma – 6 ECTS (5%) <p>GVJ vuri re gjatë pyetjeve në institucion që kjo natyrë informacioni që ju ofrohet studentëve nga ky program studimi, ka lehtësuar punësimin në fushat sipas studimit të kryer. Nga analizat vjetore e periodike të punës mësimore të bëra në departament rezulton se programi ka arritje të objektivave formuese të tij.</p> <p>(Aneksi Nr. 9: Plani mësimor; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB; Aneksi Nr. 11: Studimi i Tregut të Punës).</p>		
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			X

Standardi II.3

Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe



Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktivitetëve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që programi i studimit profesional “Dizajn dhe Zhvillim Software” është i organizuar në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH” dhe me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të Lartë”, i ndryshuar. U vu re nga GVJ që vlerësimi në kredite bëhet sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Plani mësimorë, paraqet të gjitha informacionet e nevojshme rreth organizimit të lëndëve dhe moduleve siç është ndarja në semestra, kreditet, tipologjia, ndarja mes orëve teorike dhe praktike, etj.</p> <p>U vu re nga GVJ që krahas planit mësimor, studentët njihen edhe me silabuset e lëndëve që ato ndjekim ku janë përcjellë të gjitha informacionet e nevojshme si: objektivat e lëndës, plani përgjatë semestrit, format e vlerësimit, literatura bazë dhe ajo e rekomanduar, si dhe çdo informacion shtesë që aplikohet për lëndën në fjalë.</p> <p>Secila lëndë është e vlerësuar në kredite (ECTS) sipas tipit të veprimtarisë (A-E) dhe orë mësimore (leksionesh, seminare, detyra kursi, projekt kursi, laborator).</p> <p>(Aneksi Nr. 9: Plani mësimor; Aneksi Nr. 6: Rregullore e programit të studimit; Aneksi Nr. 10: Silabuset e lëndëve ; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB)</p>
<p>Kriteri 2. Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkua/të pritshme nga punëdhënësit.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që përmbajtja e planit mësimor ka në thelb përcjelljen e njohurive sa më praktike në kuadrin e një programi studimi profesional. Në vitin e parë të studimit studentët marrin disa koncepte matematikore mbi analizën matematike dhe algjibrën lineare dhe bazat e programimit. Në vitin e dytë të studimit, marrin njohuri të përgjithshme mbi teknologjinë e informacionit. Këto njohuri i shërbejnë për të kuptuar infrastrukturën që përdorin sistemet e komputacionit dhe zhvillimet e aplikacioneve.</p> <p>Bazuar në përjasjen e arkitekturave software me 3 nivele, studenti fokusohet në semestrin e dytë tek analiza dhe menaxhimi i dhënave (niveli i parë), semestrin e tretë të zhvillimi i “logjikës së biznesit” (<i>business logic</i>, e njohur edhe si “<i>back-end</i>”, niveli i dytë) dhe për ta përmbyllur në semestrin e katërt me pjesën e ndërfaqes grafike (<i>user-inteface</i>, niveli i tretë).</p> <p>Lëndët e programit mundësojnë marrjen e njohurive dhe kompetencave të nevojshme për kërkesën e tregut.</p> <p>Gjithashtu programi ka praktikën ku kompanitë kanë mundësi për trajnimin e tyre edhe me nevojat praktike. Ajo që programi ka për qëllim është të përcjelli përjasjet e përdorura në kontekste të ndryshme si dhe të studiohen familje të ndryshme të gjuhëve të programimit siç është: procedurale, e orientuar në objekte, web dhe mobile. U vu re nga GVJ që ky është brezi i parë nga i cili diplomohen studentët, dhe nuk ka analizë për të dhënat në lidhje me punësimin e studentëve në kompani të ndryshme, megjithatë u morën informacione gjate vizitës nga pyetjet në institucion, që gjithashtu UMT prej vitesh ofron programe studimi në fushën e teknologjisë së informacionit ndaj</p>

	<p>ka një eksperiencë të gjatë në fushën e zhvillimit software. U vu re që ka marrëveshje me disa kompani, kryesisht në Tiranë, ku studentët të UMT-së punojnë dhe japin një informacion rreth eksperiencës së tyre në lidhje aftësimin e tyre dhe nevojave të kompanisë.</p> <p>Studentët e programit profesional Dizajn dhe Zhvillim Software, në kuadër të projektit CTBE-TMD do të zhvillojnë praktikatat profesionale pranë kompanive “Albanian Business Partner” dhe “SoftMogul”. Programi përmban të gjithë elementët e nevojshëm që studentët e diplomuar ti përshtaten sa më mirë tregut të punës.</p> <p>(Aneksi Nr. 9: Plani mësimor; Aneksi Nr. 49: Projektit CTBE-TMD; Aneksi Nr. 6: Rregullore e programit të studimit; Aneksi Nr. 10: Silabuset e lëndëve; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB).</p>
<p>Kriteri 3. Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjate vizitës në institucion që përmbajtja e planit mësimor ka në thelb përcjelljen e njohurive sa më praktike në kuadrin e një programi studimi profesional. Në vitin e parë të studimit studentët marrin disa koncepte matematikore mbi analizën matematike dhe algjebren lineare dhe bazat e programimit. Në vitin e dytë të studimit, marrin njohuri të përgjithshme mbi teknologjinë e informacionit. Këto njohuri i shërbejnë për të kuptuar infrastrukturën që përdorin sistemet e komputacionit dhe zhvillimet e aplikacioneve.</p> <p>Bazuar në përjasjen e arkitekturave software me 3 nivele, studenti fokusohet në semestrin e dytë tek analiza dhe menaxhimi i dhënave (niveli i parë), semestrin e tretë të zhvillimi i “logjikës së biznesit” (<i>business logic</i>, e njohur edhe si “<i>back-end</i>”, niveli i dytë) dhe për ta përmbyllur në semestrin e katërt me pjesën e ndërfaqes grafike (<i>user-inteface</i>, niveli i tretë).</p> <p>Çdo vit akademik syllabuset rishikohen dhe përmirësohen në përputhje të plotë me planin mësimor, bazën ligjore në fuqi dhe aktet rregullatore të miratuara nga UMT-ja si dhe kërkesat e tregut të punës, Gjithashtu programi ka praktikën ku kompanitë kane mundësi për trajnimin e tyre edhe me nevojat praktike. Ajo që programi ka për qëllim është të përcjell përjasjet e përdorura në kontekste të ndryshme si dhe të studiohen familje të ndryshme të gjuhëve të programimit siç është: procedurale, e orientuar në objekte, web dhe mobile. U vu re nga GVJ që ky është brezi i parë nga i cili diplomohen studentët, dhe nuk ka analizë për të dhënat në lidhje me punësimin e studentëve në kompani të ndryshme, megjithatë u morën informacione gjatë vizitës nga pyetjet në institucion, dhe gjithashtu UMT prej vitesh ofron programe studimi në fushën e teknologjisë së informacionit ndaj ka një eksperiencë të gjatë në fushën e zhvillimit software. U vu re që ka marrëveshje me disa kompani, kryesisht në Tiranë, ku studentët të UMT-së punojnë dhe japin një informacion rreth eksperiencës së tyre në lidhje aftësimin e tyre dhe nevojave të kompanisë.</p> <p>Studentët e programit profesional Dizajn dhe Zhvillim Software, në kuadër të projektit CTBE-TMD do të zhvillojnë praktikatat profesionale pranë kompanive “Albanian Business Partner” dhe “SoftMogul”. Programi përmban të gjithë elementët e nevojshëm që studentët e diplomuar ti përshtaten sa me mire tregut të punës.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ bëri vizitë edhe në bibliotekë, ku pati mundësi të shikonte të depozituara materiale të përgatitura nga</p>

	<p>pedagogët për lëndë të ndryshme, dhe ku studenti kishte mundësi aksesit në to për të marrë materialet.</p> <p>(Aneksi Nr. 9: Plani mësimor; Aneksi Nr. 49: Projektit CTBE-TMD; Aneksi Nr. 6: Rregullore e programit të studimit; Aneksi Nr. 10: Silabuset e lëndëve; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB).</p>
<p>Kriteri 4. Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përftimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që përmbajtja e planit mësimor ka në thelb përcjelljen e njohurive sa më praktike në kuadrin e një programi studimi profesional. Përmes përgatitjes së studentëve realizohet synimi kryesor i programit që ndërthurur njohuritë teorike dhe aplikimin praktik të lidhura të dyja direkt me kërkesën e tregut të punës. Vumë re që në syllabuset e lëndëve tematikat janë bashkëkohore. Çdo vit akademik syllabuset rishikohen dhe përmirësohen në përputhje të plotë me planin mësimor, bazën ligjore në fuqi dhe aktet rregullatore të miratuara nga UMT-ja si dhe kërkesat e tregut të punës. Në vitin e parë të studimit studentët marrin disa koncepte matematikore mbi analizën matematike dhe algjibrën lineare dhe bazat e programimit. Në vitin e dytë të studimit, marrin njohuri të përgjithshme mbi teknologjinë e informacionit. Këto njohuri i shërbejnë për të kuptuar infrastrukturën që përdorin sistemet e komputacionit dhe zhvillimet e aplikacioneve.</p> <p>Bazuar në përfaqshjen e arkitekturave software me 3 nivele, studenti fokusohet në semestrin e dytë tek analiza dhe menaxhimi i dhënave (niveli i parë), semestrin e tretë të zhvillimi i “logjikës së biznesit” (<i>business logic</i>, e njohur edhe si “<i>back-end</i>”, niveli i dytë) dhe për ta përmbyllur në semestrin e katërt me pjesën e ndërfaqes grafike (<i>user-inteface</i>, niveli i tretë).</p> <p>Gjthashtu programi ka praktikën ku kompanitë kanë mundësi për trajnimin e tyre edhe me nevojat praktike. Ajo që programi ka për qëllim është të përcjelli përfaqshjet e përdorura në kontekste të ndryshme si dhe të studiohen familje të ndryshme të gjuhëve të programimit siç është: procedurale, e orientuar në objekte, web dhe mobile. U vu re nga GVJ që ky është brezi i parë nga i cili diplomohen studentë, dhe nuk ka analizë për të dhënat në lidhje me punësimin e studentëve në kompani të ndryshme, megjithatë u morën informacione gjatë vizitës nga pyetjet në institucion. Gjithashtu UMT prej vitesh ofron programe studimi në fushën e teknologjisë së informacionit ndaj ka një eksperiencë të gjatë në fushën e zhvillimit software. U vu re që ka marrëveshje me disa kompani, kryesisht në Tiranë, ku studentët të UMT-së punojnë dhe japin një informacion rreth eksperiencës së tyre në lidhje aftësimin e tyre dhe nevojave të kompanisë.</p> <p>Studentët e programit profesional Dizajn dhe Zhvillim Software, në kuadër të projektit CTBE-TMD do të zhvillojnë praktikën profesionale pranë kompanive “Albanian Business Partner” dhe “SoftMogul”. Programi përmban të gjithë elementët e nevojshëm që studentët e diplomuar ti përshtaten sa më mirë tregut të punës.</p> <p>Ata nxiten përmes pjesës praktike dhe metodave të ndryshme të mësimdhënies përfshirë këtu edhe detyrat e kursit, projektet, etj për të pasur mendim kritik dhe për ti ilustruar në praktikë njohuritë e marra.</p> <p>(Aneksi Nr. 9: Plani mësimor; Aneksi Nr. 49: Projektit CTBE-TMD;</p>

	Aneksi Nr. 6: Rregullore e programit te studimit; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB).			
Kriteri 5. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që përmbajtja e planit mësimor ka në thelb përcjelljen e njohurive sa më praktike në kuadrin e një programi studimi profesional. GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që DIFSH-i, përgjegjës i programit DP, TI&AI me profile, kryejnë në mënyrë periodike konsultime dhe marrin parasysh propozimet nga biznesi dhe kompanitë private mbi ndryshimet e tregut të punës. Këto propozime shërbejnë për përmirësimin e përmbajtjes së programit.</p> <p>Ajo që programi ka për qëllim është të përcjell përfaqset e përdorura në kontekste të ndryshme si dhe të studiohen familje të ndryshme të gjuhëve të programimit siç është: procedurale, e orientuar në objekte, web dhe mobile. U vu re nga GVJ që ky është brezi i parë nga i cili diplomohen studentë, dhe nuk ka analize për të dhënat në lidhje me punësimin e studentëve në kompani të ndryshme, megjithatë u morën informacione gjatë vizitës nga pyetjet në institucion, dhe gjithashtu UMT prej vitesh ofron programe studimi në fushën e teknologjisë së informacionit ndaj ka një eksperiencë të gjatë në fushën e zhvillimit software. U vu re që ka marrëveshje me disa kompani, kryesisht në Tiranë, ku studentë të UMT-së punojnë dhe japin një informacion rreth eksperiencës së tyre në lidhje aftësimin e tyre dhe nevojave të kompanisë.</p> <p>Studentët e programit profesional Dizajn dhe Zhvillim Software, në kuadër të projektit CTBE-TMD do të zhvillojnë praktikatat profesionale pranë kompanive “Albanian Business Partner” dhe “SoftMogul”. Programi përmban të gjithë elementët e nevojshëm që studentët e diplomuar ti përshtaten sa më mirë tregut të punës.</p> <p>(Aneksi Nr. 9: Plani mësimor; Aneksi Nr. 49: Projektit CTBE-TMD; Aneksi Nr. 6: Rregullore e programit te studimit; Aneksi Nr. 12: Lista e kompanive bashkëpunim; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikatat më të mira të fushës	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizites në institucion që Statuti i universitetit paraqet strukturën organizative (fakultete dhe departamente) dhe përcakton përgjegjësitë e tyre për organizimin e procesit mësimor dhe monitoron cilësisë e procesit. Vume re edhe gjatë pyetjeve gjatë vizitës që përgjegjësi kryesor për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies është Përgjegjësi i Departamentit. Ai analizon punën e anëtarëve të stafit. Monitorimi i procesit mësimor bëhet nga përgjegjësi i programit të studimit i cili raporton në mënyrë të vazhdueshme tek Përgjegjësi i Departamentit. Sipas situatave, Përgjegjësi i Departamentit kontakton me pedagogët për tu përcjellë informacionin. Raporti i përgatitur nga Përgjegjësi i Departamentit dorëzohet në Fakultet dhe pastaj i përcillet Rektoratit.</p> <p>Gjithashtu vumë re që në fund të semestrit, shpërndahet pyetësori të studentët përmes sistemit Edu4School. Përmes këtij pyetësori merret vlerësimi për pedagogun dhe lëndën. Pasi të mblidhen të dhënat, rezultatet i përcillen Zyrës së Rektorit nga Sekretaria Mësimore.</p> <p>Përveç këtij mekanizmi, UMT ka Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Kjo njësi përbëhet nga të paktën 6 anëtarë (akademikë, administrativ dhe një student) të cilët, ndër të tjera, bëjnë vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive akademike. Kjo njësi ka për objektin strategjik përmirësimin e vazhdueshëm të kulturës së cilësisë në UMT, bashkëpunon me rektoratin, trajnon vazhdimisht personelin e saj, dhe sensibilizon të gjithë stafet akademike, ndihmës, administrativ, dhe studentët në fushën e cilësisë. Gjithashtu në dokumentin e raporteve vjetore për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, vumë re të dhëna dhe evidenca në mënyrë krahasimore sipas disa fushave si organizimi dhe menaxhimi i institucionit, burimet, kurrikulat, kërkimi shkencor, studentët.</p> <p>(Aneksi Nr. 20: Rregullorja e NJSBC; Aneks Nr. 21 Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë; Aneksi Nr. 53: Vendim mbi përbërjen e NJSBC 21-22; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB)</p>
<p>Kriteri 2. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që rregullorja e UMT-s (Neni 29) përcakton se elementët kryesorë të mësimdhënies dhe mësimnxënies si më poshtë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit, praktikatat mësimore, orët për leksionet e hapura dhe forma të tjera sipas rastit. Këto forma i tregohen studentit me anë të silabusit të lëndës si dhe diskutohen në takimin e parë që lektori ka me studentët me fillimin e procesit mësimor.</p> <p>I gjithë materiali didaktik hidhet në platformën Edu4School ku studentët kanë mundësi të marrin materialet direkt nga sistemi dhe në bibliotekën e UMT-s. Gjithashtu gjatë vizitës vumë re që</p>

	<p>universiteti ofron laboratorë me kushte bashkëkohore. Për zhvillimin e orëve laboratorike, vumë re që në fillim të studimeve të tyre studentët pajiseshin me një laptop. Në këtë laptop instaloheshin programet përkatëse që ju duheshin atyre sipas profileve.</p> <p>(Aneksi Nr. 2: Rregullore UMT; Aneksi Nr. 6: Rregullore e programit të studimit; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB)</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që personeli akademik merr parasysh natyrën specifike të programit të studimit dhe ka përdorur metoda të larmishme të mësimdhënies. Nisur nga natyra e programit profesional të studimit, një rëndësi e veçantë i është kushtuar punës në laborator si dhe aspektit praktik duke ndërthurur në vlerësim projekte apo detyra kursi. Për zhvillimin e orëve laboratorike, vumë re që në fillim të studimeve të tyre studentët pajiseshin me një laptop. Në këtë laptop instaloheshin programet përkatëse që ju duheshin atyre sipas profileve.</p> <p>NJSBC-ja harton pyetësorin përkatës për matjen e kënaqësisë së studentit lidhur me zhvillimin e procesit mësimor rezultatet e të cilit kanë qenë objekt diskutimi dhe përmirësimi konkret në format e mësimdhënies.</p> <p>Gjatë pyetjeve vumë re që në periudhën e pandemisë, kishte rritje përdorimi i materialeve në formë elektronike. Për tu ardhur në ndihmë disa lëndëve specifike, leksionet janë zhvilluar në ambient virtual, duke i mundur lektorit praninë në klasë në mbështetje të kamerave me rezolucion të lartë për transmetimet në “streaming” ndërsa studentët ndiqnin nga distanca.</p> <p>Për programin e studimit 2-vjeçar profesional në Dizajn dhe Zhvillim Software, studentët përdorin ambiente të ndryshme zhvillimi (të njohura si IDE – Integrated Development Environment).</p> <p>(Aneksi Nr. 21: Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB)</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që ka staf akademik të specializuar në fushat përkatëse ku ata janë të angazhuar në mësimdhënie dhe janë kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Stafi akademik përdor mënyra, metoda alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me këtë program studimi, sipas temave dhe profileve.</p> <p>Stafi pedagogjik i përfshirë në mësimdhënie është me eksperiencë dhe i angazhuar edhe në programe studimi të tjera si Bachelor dhe Master i Shkencave dhe ka njohuritë e nevojshme për zhvillimin e mësimin në kushtet optimale. Klasat janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një proces efektiv të mësimnxënies.</p> <p>Për realizimin e programit PrDZhS, janë laboratorë, klasa, zyra të mjaftueshme, dhe lehtësira të tjera me pajisje elektronike dhe teknologji të informacionit. Stafi akademik përdor metodologji efektive të mësimdhënies bazuar në TIK, me anë të kompjuterave në klasë. Gjithashtu kompjuterat e vendosur në laboratorë përmbajnë të gjithë programet dhe paketat e nevojshme sipas lëndëve specifike të këtij programi studimi. Vumë re gjatë vizitës në institucion që klasat,</p>

	laboratorët e kompjuterave dhe laboratorit i elektrikes janë të pajisura me mjetet, programet e nevojshme. (Aneksi Nr. 23: CV e Stafit Akademik; 6. Tabelat përmbledhëse Tabela 6: Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit; pyetjet gjatë vizitës në institucion; RVB)			
Kriteri 5. Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që institucioni vlerëson dhe përmirëson periodikisht format dhe metodat e mësimdhënies. Një nga format e përdorura është përmes Pyetësorit të Vlerësimit të pedagogut të lëndës, i cili është një nga mjetet kryesore që përdoret për të monitoruar cilësinë e mësimdhënies. Ky pyetësor vumë re që zhvillohet para fillimit të provimit final të lëndës. Rezultatet e dalta nga pyetësorët përdoren si një kontribut për përmirësime të mëtejshme. Stafit akademik i programit të studimit PrDZhS ofron metoda pedagogjike shumë të larmishme dhe të ndryshueshme përveç mësimdhënies së zakonshme siç janë leksionet dhe seminarët, studentët marrin pjesë në punë laboratorike, dorëzojnë detyra kurseve dhe projekte, si edhe mbajnë prezantime. Vumë re që ka një larmishmëri të metodologjisë së mësimdhënies, dhe metoda mjaft ndërvepruese. Gjatë leksioneve dhe seminareve, studentët vumë re që janë të lirë për pyetje dhe komente. Nga ana tjetër, prezantimet e studentëve janë të organizuara në formën e diskutimeve duke i bërë klasat më tërheqëse dhe ndërvepruese. Stafit angazhohet edhe në molilitete Erasmus + ose konferenca nga ky përveç të tjerave mund të merren dhe përvehtësohen edhe mënyra të shumëllojshme mësimdhënie, përmes shembujve të praktikave të mira. Një metodë ndihmëse në mësimdhënie dhe mësimnxënie mund të përmendim platformat Edu4School dhe GoToMeeting. (Aneksi Nr. 24 - Model i pyetësorit për studentët; Aneksi Nr. 10. Silabuset e lëndëve; Aneksi Nr. 25. Shembuj nga përdorimi i Edu4School dhe GoToMeeting; pyetjet gjatë vizitës në institucion; RVB)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të	GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që UMT ofron kushte teknike dhe higieno-sanitare shumë të mira (edhe në kushtet e pandemisë). Institucioni i ka pajisur godinat e tij me pajisje moderne. Përveç punonjësve sanitarë të punësuar në institucion, nga drejtuesit

<p>procesit mësimor.</p>	<p>punësohen edhe kompani pastrimi. Vumë re gjatë pyetjeve në institucion që janë punësuar një ekip teknikësh me përvojë që kryejnë mirëmbajtjen e të gjitha objekteve, materialet, sistemin elektrik, ngrohjen e të gjitha ambienteve të brendshme në dimër, ajrin e kondicionuar në verë. Procesi mësimor me pjesën teorike dhe praktike kryhet në ambiente të përshtatshme dhe me cilësi.</p> <p>Vumë re që klasat kishin video-projektorë, sisteme audio, lidhje interneti wireless. Për të mundësuar një metodologji më efektive të mësimdhënies bazuar në TIK, kompjuterat në klasë dhe kompjuterat e vendosur në laboratorë përmbajnë të gjitha programet dhe paketat e nevojshme për lëndët specifike të këtij programi studimi.</p> <p>(Aneksi Nr. 32: Lista e laboratoreve në funksion të programit të studimit ; Aneksi Nr. 37: Asetet Infrastrukturore, akademike UMT; pyetjet gjatë vizitës në institucion; RVB)</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që stafi akademik dhe studentët përdorin sisteme të ndryshme informacioni. Ata kanë në dispozicion një infrastrukturë të konsoliduar të IT-së të nevojshme për procesin e mësimdhënies. Vumë re që nga regjistrimi i tyre, studentët pajisen me një adresë elektronike. Kjo adresë @umt.edu.al, me bazë Microsoft Service ju ofron studentëve dhe stafit mundësi të mëdha, si memorie të pakufizuara të EMail, OneDrive, Microsoft Teams, etj. Me anë të kësaj adrese elektronike, studentët kishin akses në llogarinë e tyre personale në sistemin e UMT (Edu4School) nga ku aksesojnë materialet e hedhura nga pedagoget, shohin notat dhe mungesat e tyre dhe çështjet te tjera që lidhen me marrëdhëniet e tyre me universitetin. Vumë re që përmes këtij sistemi, çdo pedagog mund të hapë llogarinë e lëndës nga e cila u dërgon materialet e leksioneve, studentët dërgojnë projektet e tyre ose detyrat dhe aktivitete të tjera të ngjashme, të nevojshme për lëndët specifike. Përdorimi i platformes Edu4School shërben për hedhjen e rezultateve të studenteve dhe gjenerimin e procesverbaleve.</p> <p>(Aneksi Nr. 25: Shembuj nga përdorimi i Edu4School dhe GoToMeeting; Aneksi Nr. 32: Lista e laboratorëve në funksion të programit të studimit; pyetjet gjatë vizitës në institucion; RVB)</p>
<p>Kriteri 3. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që pedagogët e departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike përdorin tekste mësimore bashkëkohore të cilat janë të pasqyruar në syllabuset e lëndës. Kjo literaturë zgjerohet në vijimësi dhe vihet në shërbim të studentëve. Gjithashtu, shumë pedagogë kanë përgatitur cikle leksionesh. Këto cikle leksionesh përmirësohen vazhdimisht. Vumë re që një kopje e materialeve ishte në bibliotekë. Studenteve u ofrohet edhe literature ndihmëse nga botimet e fundit në fushat përkatëse të vetë pedagogëve mësimdhënës. Studentët kishin akses në kopje elektronike të materialit të siguruar nga stafi akademik nëpërmjet platformës të</p>

	<p>disponueshme online Edu4School.</p> <p>Biblioteka kishte një fond librash për programin. Ato janë të mjaftueshëm për kryerjen e suksesshme të programit të studimit profesional. Librat në bibliotekë janë inventarizuar dhe ndarë sipas fushave dhe temave. Literatura e bibliotekës mund të gjendet në gjuhë të ndryshme, kryesisht shqip dhe anglisht. Koleksioni i bibliotekës pasurohej me blerje dhe dhurime nga persona të ndryshëm fizikë dhe juridikë. Librat e blerë zgjidhen sipas nevojave dhe kërkesave të studentëve dhe stafit akademik. Fondi i bibliotekës vumë re që përditësohet çdo vit. Nga vizita në institucion vumë re që me përmirësimin dhe ngritjen e godinës së re edhe biblioteka do të kishte akoma më shumë ambient.</p> <p>(Aneksi Nr. 25: Shembuj nga përdorimi i Edu4School dhe GoToMeeting; pyetjet gjatë vizitës në institucion; RVB)</p>
<p>Kriteri 4. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion që biblioteka ju mundëson aksesin në libraritë online si personelit akademik, ashtu edhe studentëve. Stafit i bibliotekës ofron mbështetje në gjetjen e burimeve on-line të kërkuara.</p> <p>Biblioteka është e pajisur me PC. Në këto mënyrë studentët kanë mundësi të lexojnë në libraritë online të vëna në dispozicion nga UMT dhe të punojnë aty. Nga vizita në institucion vumë re që me përmirësimin e ambienteve dhe ngritjen e godinës së re edhe biblioteka do të kishte akoma më shumë ambient.</p> <p>(Pyetjet dhe konstatimet gjatë vizitës në institucion)</p>
<p>Kriteri 5. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që studentët e UMT kanë akses të pakufizuar në shërbimet e rrjetit me internet wireless dhe paketën Office365, etj.</p> <p>Vumë re që kishte 3 laboratorë me kompjutera, një dhomë studimi për studentët dhe një bibliotekë me PC ku studentët dhe anëtarët e stafit kishin mundësi që të kenë internet.</p> <p>Për zhvillimin e procesit mësimor, departamenti ka në dispozicion 2 laboratorë kompjuterikë. Me mirëmbajtjen e laboratorëve të pajisur me kompjutera merreshin laborantët. Gjithashtu ata u ofrojnë ndihmë studentëve për të punuar për detyrat e kursit dhe temat e diplomave. Laborantët kanë kualifikimet e nevojshme për vendin e punës dhe janë në dispozicion për çdo nevojë të studentëve.</p> <p>(Pyetjet dhe konstatimet gjatë vizitës në institucion)</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që për të ardhur në ndihmë procesit mësimor, kombinohet forma në auditor me formën jashtë tij, nëpërmjet platformës së sistemit të teknologjisë elektronike Edu4School. Me anë të kësaj platforme bëhet e mundur hedhja e materialeve didaktike dhe komunikimi me studentët për të gjitha problemet e mësimdhënies dhe mësimnxënies. UMT ka aplikuar mësimdhënien në distancë nëpërmjet platformës GotoMeeting që</p>

	<p>në javët e para të ndërprerjes së procesit mësimor me rastin e COVID 19. Me Edu4School studentët aksesojnë materialet e hedhura nga pedagogët, shohin notat, mungesat dhe çështje të tjera që lidhen me marrëdhëniet e tyre me universitetin. Vumë re që përmes këtij sistemi, çdo pedagog mund të hapë llogarinë e lëndës, u dërgon materialet e leksioneve, studentët dërgojnë projektet e tyre ose detyrat dhe aktivitete të tjera të ngjashme, të nevojshme për lëndët perkatese.</p> <p>(Pyetjet dhe konstatimet gjatë vizitës në institucion; Aneksi Nr. 25: Shembuj nga përdorimi i Edu4School dhe GoToMeeting)</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që UMT-ja synon përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ky proces mbikëqyrjet në të gjitha fazat e tij. Vumë re që për arsye të mbikëqyrjes së këtij procesi janë ndërmarrë disa nisma. FSHKIT përcakton koordinatorët e programeve të studimit që kanë për detyrë mbikyrjen e cilësisë. Në komunikim të vazhdueshëm me studentët, merr informacione mbi problematikat që shfaqen gjatë procesit mësimor. Konstatuam që NJSBC ishte gjithashtu një strukturë që realizonte kontrollin dhe mbikëqyrjen. Ajo kishte si mision ndërtimin, mirëmbajtjen dhe auditimin e sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë në UMT. Gjithashtu përcaktonte, orientonte dhe monitoronte ose kontrollonte gjithë përgjegjësitë me cilësinë në të gjitha hallkat. Të gjitha këto struktura bënin edhe përhapjen dhe promovimin e eksperiencave më të mira si në mësimdhënie ashtu edhe mësimnxënies. Synimi i NJSBC në plan afatgjatë ishte i lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të kulturës së cilësisë në UMT.</p> <p>(Aneksi Nr. 20: Rregullore e NJSBC; Pyetjet dhe konstatimet gjatë vizitës në institucion)</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ishte përgjegjës për ndërgjegjësimin e stafit akademik dhe studentëve për sa i përket cilësisë të mësimdhënies. Ky është një proces i plotë që fillon nga punësimi i pedagogëve cilësorë përmes një procedure të plotë në përputhje me rregulloren e UMT. Në departament janë punësuar rregullisht pedagogë nëpërmjet të shpalljes publike të vendeve të lira të</p>

	<p>punës. Në shumë raste, stafi akademik dhe studentët janë të ftuar në leksionet demonstruese të mbajtura nga aplikantët. Gjithashtu nga pyetjet në institucion vumë re që për stafin e ri të marrë, kishte herë pas here orë monitorimi gjatë leksioneve nga departamenti, me njoftim paraprak të tyre, duke ruajtur pozicionin dhe lirinë e pedagogëve por edhe për të kontrolluar cilësinë.</p> <p>(Aneksi Nr. 5: Rregullore e FSHKIT; Pyetjet dhe konstatimet gjatë vizitës në institucion)</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që Universiteti Metropolitan Tirana, ofron mundësinë e kualifikimit të mëtejshëm të personelit si nëpërmjet kërkimeve dhe studimeve brenda vendit ashtu edhe nëpërmjet kërkimeve jashtë vendit. Vumë re që kualifikimi jashtë vendit realizohej nëpërmjet studimeve të ndryshme afatshkurtra ose afatgjata, si dhe nëpërmjet programeve të mobilitetit të pedagogëve. Për këtë qëllim UMT-ja ka lidhur një seri marrëveshjes me organizata/institucione të ndryshme ndërkombëtare dhe ka realizuar disa projekte mobiliteti një ndër të cilët është ERASMUS. Departamenti i Inxhinierise Kompjuterike mban kontakte të vazhdueshme me kompani të ndryshme të operojnë në Shqipëri për vlerësuar edhe nevojat e tyre si dhe përshtatjen e këtyre nevojave në procesin e mësimdhënies. Stafi vazhdimisht angazhohet për të përmirësuar mësimdhënien, duke aplikuar edhe metoda të mësuara jashtë, dhe metoda të para gjatë punës së tyre studimore si më të përshtatshme sipas lëndëve dhe natyrës së programit profesional.</p> <p>(Aneksi Nr. 12: Lista e kompanive bashkëpunim; Aneksi Nr. 13: Lista e universiteteve mobilitetit; Pyetjet dhe konstatimet gjatë vizitës në institucion)</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që përfshirja e personelit akademik në aktivitete shkencore dhe programet e shkëmbimit janë një proces që i shërben personelit akademik si për rritjen e nivelit të kualifikimit ashtu edhe në drejtime të rritjes së aftësisë së tyre në mësimdhënie dhe zbatimin e metodave të reja.</p> <p>Në veçanti, stafi i ri akademik, është përfshirë në aplikimin për hapjen e programit të doktoraturës që UMT po aplikon. Vumë re që përfshirja e tyre është cilësuar si një formë trajnimi ku të zhvillohet mendimi kritik duke u paraqitur ideve konkrete për studim dhe duke u studiuar plani i fizibilitetit të idesë së tyre. Vumë re që kualifikimi jashtë vendit realizohej nëpërmjet studimeve të ndryshme afatshkurtra ose afatgjata, si dhe nëpërmjet programeve të mobilitetit të pedagogëve. Për këtë qëllim UMT-ja ka lidhur një seri marrëveshjes me organizata/institucione të ndryshme ndërkombëtare dhe ka realizuar disa projekte mobiliteti një ndër të cilët është ERASMUS.</p> <p>(Aneksi Nr. 12: Lista e kompanive bashkëpunim; Aneksi Nr. 13: Lista e universiteteve mobilitetit; Pyetjet dhe konstatimet gjatë</p>

	vizites në institucion, RVB)			
Kriteri 5. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që stafi akademik vazhdimisht angazhohet për të përmirësuar mësimdhënien, duke aplikuar edhe metoda të mësuara jashtë, dhe metoda të para gjatë punës së tyre studimore si më të përshtatshme sipas lëndëve dhe natyrës së programit profesional. Stafi akademik përfshin metoda të reja prezantimi në mësimdhënie nëpërmjet prezantimeve me projektor, përfshirjes se eksperteve të fushës së programit dhe lëndës në leksione, analizimit të shembujve real, përdor ambiente të ndryshme zhvillimi dhe testimi, etj. Përveç aplikimit të metodave inovative në mësimdhënie, personeli akademik dhe ndihmës raportojnë tek përgjegjësit e departamentit lidhur me rezultatet e punës. Stafi akademik dhe ndihmës (përfshirë asistent pedagogët, asistentët e mësimdhënies) testojnë metoda të reja të mësimdhënies, duke analizuar efektet e tyre dhe raportojnë informacionin tek departamenti mbi gjetjet. Procesi i mësimdhënies është i lidhur ngushtë me nivelin e studentëve që vijnë nga cikli i parë i studimeve dhe ndryshimet në kurrikulat e tyre universitare (nqs jane jashtë UMT). Në këtë rast monitorohej performanca e tyre akademike duke zbatuar përfshirjen e mentorëve për studentët e programit. (Pyetjet dhe konstatimet gjatë vizitës në institucion, RVB)			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimmimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, aftësive, kompetencave profesionale përcaktohen në Rregulloren e provimeve. Në këtë rregullore janë parashikuar elementet e procesit të vlerësimit ku kontrolli i dijeve bëhet nëpërmjet: a) Provimit me shkrim. b) Provimit me gojë. c) Kombinimit të dy formave. Mënyra e vlerësimit përcaktohet edhe në syllabuset e çdo lënde në bazë të specifikave të saj. Në rregullore janë të detajuara çështjet që lidhen me provimet,

	<p>parakushtet për hyrjen në provim, pjesëmarrja në provim, dokumentatat e vlerësimit etj.</p> <p>Studentet njihen me këto rregullore si një e drejtë dhe detyrim i tyre, si dhe janë parashikuar si pjesë përbërse e kontratës së studimit. Ato ishin të publikuara dhe studentët mund t'i aksesonin ato në çdo moment.</p> <p>(Aneksi Nr. 26 – Rregullorja e provimeve; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB).</p>
<p>Kriteri 2. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. <i>pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB).</i></p>	<p>Nga vizitat në UMT, GVJ, konstaton se mbajtja e provimeve është bërë konform rregullores së provimeve. Sipas Rregullores së provimeve. Testimi i njohurive dijeve dhe aftësive të fituara nga studentët realizohet duke vlerësuar me pikë pjesëmarrjen dhe aktivizimin, detyrat e kursit, (projekte etj), laboratorët, provimet e ndërmjetme dhe provimit përfundimtar. Në nivel programi studenti vlerësohet edhe për praktikën dhe detyrimet përmblyllëse për mbrojtjen e diplomës. Teza e provimit hartohet duke kombinuar pyetjet me alternativa, zbërthim konceptesh, ushtrime praktike si dhe ushtrime të ndryshme sipas lëndës. Mënyra e vlerësimit dhe shpërndarja e pikëve brenda lëndës bëhet sipas modelit të detajuar (model teze) gjithsej 100 pikë, ku provimi përfundimtar përbën 60% të vlerësimit të përgjithshëm.</p> <p>Në rregullore është parashikuar qartë dokumentimi i vlerësimit të studentëve.</p> <p>(Aneksi Nr. 26 – Rregullorja e provimeve; Aneksi Nr. 28: Vendimi i Senatit për vlerësimin e vazhduar)</p>
<p>Kriteri 3. Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.</p>	<p>GVJ në takime me studentet konstatoi se gjatë javës së parë të secilit semestër, studentëve u prezantohen objektivat e lëndës, rezultatet e mësimnxënie, temat, dhe metoda e vlerësimit të lëndës, si dhe litartura në dispozicion. Anëtarët e stafit akademik prezantojnë para studentëve të gjitha elementet e lartpërmendura; marrin pyetje dhe reagime dhe ngarkojnë në sistem temat që do të zhvillohet për të gjitha javët. Ky informacion ishte i aksesueshëm nga studentët gjatë gjithë vitit akademik.</p> <p>(Pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB).</p>
<p>Kriteri 4. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimat, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ bazuar në verifikimet në UMT , konstaton se, UMT me qëllim që të sigurojë një angazhim të vazhdueshëm të njohurive/dijeve të studentëve ka një strukturë të mirëpërcaktuar të kontrollit dhe testimit gjatë gjithë vitit akademik. Në bazë vendimit të senatit nr. 119 datë 26.02.2019, vlerësimi i dijeve të studentëve bëhet duke u bazuar në pikët e grumbulluara gjatë vitit sipas formës:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 5% vlerësimi i pjesëmarrjes • 5% vlerësimi i aktivizimit gjatë lëndës • 10% laboratorë në varësi të lëndës • 10% detyra e kursit në varësi të lëndës • 10% provimi i ndërmjetëm <p>Provimi përfundimtar zë jo më pak se 60% të vlerësimit. Të gjithë detyrimet janë të përcaktuara në silabus-in e lëndës, i cili miratohet nga pedagogu përgjegjës i lëndës në bashkëpunim me</p>

	<p>drejtuesin e departamentit.</p> <p>Sipas rregullores, provimi final zhvillohet në anonimitet të plotë. Sekretaria mësimore sekreton fletën e provimit me anë të "barcode". Komisioni korrigjon provimin dhe nxjerr pikët për çdo tezë provimi. Pasi është korrigjimi i tezës, Sekretaria Mësimore shpall emrat për kodet përkatëse dhe lektori i lëndës hedh notat në sistemin elektronik Edu4School ku studentët kanë akses individual (pra mund të shohin vetëm vlerësimin e tyre). Sistemi Edu4School, përdoret edhe për vlerësimin e vazhdueshëm. Lektori apo asistenti mund të hedhin detyra të ndryshme (të njohura në sistem si Task) të cilat pasi zgjidhen nga studenti, ngarkohen në sistem. Lektori përgjegjës pasi korrigjon detyrën jep vlerësimin përkatës si dhe pikët. Akses tek vlerësimi ka vetëm studenti i cili e ka zhvilluar atë.</p> <p>(Aneksi Nr.28 - Vendimi i Senatit për vlerësimin e vazhduar; Aneksi Nr.27 - Formatet e Syllabuseve)</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi përfundimtar i njohurive dhe kompetencave të studentëve realizohet nga komisionet e provimeve, të përcaktuara që para nisjes së sezonit të provimeve. Komisionet janë të përbërë nga dy pedagogë (titullari i lëndës dhe një pedagog i fushës). Komisionet për të gjithë provimet miratohen nga Dekani i Fakultetit, sipas rregullores së përgjithshme të UMT-së dhe rregullores së provimeve.</p> <p>(Aneksi Nr. 29 - Vendimi për ngritjen e Komisioneve të provimeve Dimër 2020; Aneksi Nr. 26: Rregullore e provimeve; pyetjet gjate vizites ne institucion, RVB).</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.</p>	<p>Në rregullore është përcaktuar qartazi, detyrimi që ka çdo anëtar i stafit akademik dhe jo akademik, për detyrimin që të ndjekë kodin e etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes dhe masave ndëshkuese në raste plagjiature apo kopjimi. Ndërkohë, përgjegjësi i departamentit dhe dekani, vazhdimisht mbajnë kontakte me pedagogët, për të siguruar mbarëvajtjen e procesit mësimor.</p> <p>Secili pedagog përcakton silabus-in e lëndës, ku brenda kornizave të lejuara nga kurrikula e programit të studimit, alternon metodat vlerësuese të cilat përfshijnë kontrollin e vazhdueshëm nëpërmjet provimeve, teste me pyetje/alternativa, prezantime individuale/grup etj. Diversiteti i formave të vlerësimit, i mundëson pedagogut të vlerësojë secilin student gjatë zhvillimit të lëndës.</p> <p>Teza e provimit, sipas rregullores së provimeve, merr në konsideratë nivele të ndryshme njohurish duke filluar nga konceptet bazë për përvetësimin e një lënde deri tek njohuritë më të përparuara, dhe duke përcaktuar një vlerësim të drejtë për secilin student. Pas zhvillimit të provimit, rregullorja e provimeve përcakton një kohë tre ditore për korrigjimin e provimeve dhe pas shpalljes së rezultateve studentëve i lejohet një afat tre ditor për rishikimin e tezës. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit/rishikimit, pedagogët dorëzojnë në departament një kopje të tezës bashkë me zgjidhjet, tezat e korrigjuara dhe procesverbalin final të notave.</p>

	<p>GVJ konstaton se Institucioni garanton të drejtën e studentit për ankimim. Mbas shpalljes se rezultateve paraprake nga pedagogu, studenti ka të drejtë që brenda 72 orëve të bëjë ankesë tek pedagogu, i cili duhet ti kthejë përgjigje dhe të sqarojë studentin në lidhje me notën. Nëse studenti nuk bindet për vlerësimin e marrë, i drejtohet departamentit. Ky i fundit propozon një komision i cili miratohet nga dekani.</p> <p>Çdo kërkesë apo ankimim shqyrtohet nga komisioni fillestar i provimit i përbërë nga dy persona. Nëse studentët nuk bien dakord me vlerësimin fillestar, pasi e kanë rishikuar provimin mund të bëjnë kërkesë për rivlerësim. Në këtë rast ngrihet një komision i veçantë qëllimisht, duke respektuar rregulloren e provimeve dhe rregulloret e tjera që lidhen me procesin e provimeve në UMT.</p> <p>(Aneksi Nr. 26 - Rregullore e provimeve; Aneksi Nr.30 - Rregullore e Sekretarisë mësimore; Aneksi Nr. 31 – Rregullore e etikës UMT; Pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitim e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënit për programet me karakter profesional.	<p>GVJ Konstaton se, programi profesional i studimeve i ofron studentëve njohuri bazë teorike, praktike dhe profesionale. Përfitimi i këtyre aftësive është në fokus të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies duke punuar me studentët raste studimi, detyra në klasë, detyra në shtëpi ose detyra kursi në mënyrë individuale dhe në grup. Theks i veçantë vihet tek praktika e vazhdueshme në laboratorët e ofruara nga shkolla si edhe praktikës që zhvillohet në kompani në semestrin e fundit, aktiviteti i të cilave përputhet me natyrën e programit të studimit. Praktika në laboratorët e UMT dhe pranë kompanive i jep mundësi studentit të avancojë njohuritë dhe aftësitë profesionale dhe të zhvillojë aftësitë individuale.</p> <p>(Aneksi Nr. 6: Rregullorja e programit të studimit; Aneksi 32: Lista e laboratorëve në funksion të programit të studimi; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së	GVJ gjykon që programi profesional i studimit është hartuar i tillë që studentët të marrin njohuri teorike dhe praktike në fushën që parashikon programi. Nëpërmjet këtij programi studentët

<p>informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	<p>specializohen në një fushë specifike siç është projektimi dhe zhvillimi i aplikacioneve software. Lëndët e programit të parashikuara në kurrikula lidhen ngushtë me profesionin dhe bëjnë diferencën midis profileve të cilat ndihmojnë studentët për tu aftësuar në fushën specifike të aplikuar. UMT është pjesë e CISCO Academy që i mundëson studentët të paisen me certifikime gjatë programit të studimit. Ky është edhe një indikator që kurrikulat janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>(Aneksi Nr. 9: Plani mësimor, RVB)</p>
<p>Kriteri 3. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Nga kontrolli i syllabuseve të lëndëve GVJ konstatohet që pedagogët mbështeten në literature shqip dhe anglisht për ti ofruar studentëve një program lënde sa më te detajuar dhe inovativ. Nga kontaktet me studentet konstatohet që gjatë zbatimit të silabusit, pedagogët analizojnë pikat e forta dhe të dobëta të programit, si edhe nivelin e ndjekshmërisë të studentët. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p> <p>Për realizimin e programit profesional të studimit, lëndët si Hyrje në programim, hyrje në inxhinieri software, grafike kompjuterike etj. pra lëndët me karakter teknik, zhvillohen pjesërisht ose plotësisht në laboratorët për ti dhënë studentit njohuritë praktike. UMT ka lidhur disa marrëveshje në kuadrin e programit Erasmus+ për mobilitetin e studentëve megjithëse janë marrëveshje që fokusohen tek programet bachelor dhe master që ofrohen në fushën e teknologjisë.</p> <p>(Aneksi Nr.26 - Rregullore e provimev, (Aneksi Nr. 19: Orari Mësimor; Aneksi Nr. 10: Silabuset e Lëndëve, RVB, Vizita në Institucion)</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Nga takimet me studentet në UMT, konstatojmë se në përfundim të leksioneve, secili pedagog zhvillon një seancë përmbyllëse, si një diskutim tërësor dhe përsëritje e të gjithë temave të realizuara gjatë lëndës. Studentët kanë mundësinë të bëjnë pyetje në lidhje me paqartësi të ndryshme që kanë për lëndën, si edhe pedagogu orienton drejt pjesëve më të rëndësishme për të përsëritur për provime. Krahas orëve mësimore, lektorët vënë në dispozicioni orarin e pritjes ku i mundëson studentit takime individuale ose në grup për konsultime.</p> <p>(Aneksi Nr. 26: Rregullore e provimeve; Aneksi Nr. 30: Rregullore e Sekretarisë mësimore, Vizita në Institucion, RVB)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të paraqitur, DVV, çdo student që ndjek programin e studimit informohet mbi procedurat e diplomimit. Informacioni përcillet me anë të rregullores së studentëve dhe takimeve me përgjegjësën e programit të studimit. Siç paraqitet edhe në planin mësimor, semestrin e katërt (dhe të fundit) studentët zhvillojnë në projekt i cili shërben si temë diplome, e cila vlerësohet me 6 ECTS. Nga kontrolli i diplomave konstatojmë se studentët, për zhvillim e projektit ndiqen nga një lektor i brendshëm apo specialistw të fushës që kanë eksperiencë pune 3</p>

	deri 5 vjet. Janë përcaktuar qartë kriteret dhe elementet e punimit të diplomës, rregullat teknike, referencat, respektimi i drejtave autorit etj. (Aneksi Nr. 6: Rregullore e programit të studimit; Aneksi Nr. 33: Rregullore e Diplomës, Vizita në Institucion, RVB)								
Kriteri 6. Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.	Në rregulloren e programit të studimit, si dhe rregulloren e Diplomes, përcaktohet detyrimi që strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik angazhohen për të vënë në dispozicion të studentëve informacione dhe materialet përkatëse në shërbim të projektit individual (që kurorëzon finalizimin e studimeve). Përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me koordinatorin e programit të studimit asistojnë studentët në zgjedhjen e projektit që do të hartohet dhe pedagogut udhëheqës. FSHKIT u ofron një format të miratuar studentëve për hartimin e projektit. (Aneksi Nr. 33: Rregullore e Diplomës, RVB)								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive nga ana e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.	Për të dëshmuar plotësimin e këtij kriteri Institucioni vuri në dispozicion të GVJ dokumentacionin përkatës. Nga konsultimi me dokumentacionin, gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore GVJ konstaton që rekrutimi i PA bëhet në përputhje me bazën ligjore dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. Rekrutimi përfshin një procedurë ku kandidati plotëson një format standard i cili përmban: <ul style="list-style-type: none"> • Curriculum Vitae (format europass) ku çdo pikë e CV-së është e mbështetur me fotokopje të artikujve, abstrakteve etj; • Fotokopje e pasaportës/ID dhe adresa e banimit; • Formular vetëdeklarimi/Dëshmi Penaliteti; • Pozicioni i punës (Përgjegjës Departamenti/ përgjegjës lënde/profesor/ lektor/ asistent lektor; • Diplomat që vertetojnë arsimin bazë të lartë: - (për diplomat e huaja vërtetimi i njehsimit nga MARS);

	<ul style="list-style-type: none"> • Diplomë Doktorature / Dëshmi Titulli Shkencor • Librezë Shëndetësore • Kualifikimet (Ilojet) • Kontrata e punës <p>GVJ u njoh me realizime konkrete të procedurave të rekrutimit dhe i gjeti ato në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p> <p>(Vizita në Institucion, RVB)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>Të dhënat e personelit mblidhen, ruhen dhe përditësohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore.</p> <p>Kjo Zyrë është përgjegjëse për të mbledhur dokumentacionin dhe për të ndjekur procedurat në lidhje me rekrutimin e stafit të ri akademik, ndihmës mësitor shkencor dhe administrativ, si dhe për të përditësuar dokumentacionin e stafit ekzistues, për të ndjekur procedurat ligjore për marrëdhënien kontraktuale të tyre me institucionin. GVJ kontrollon në mënyrë rastësore dosje të personelit akademik dhe vërejtje se dokumentacioni i tyre ishte i plotë dhe i përditësuar sipas legjislacionit dhe rregulloreve të institucionit.</p> <p>(Aneksi Nr. 2: Rregullore e brendshme e UMT, Aneksi Nr. 34: Model i formularit të vlerësimit të performancës; pyetje nga vizita në Institucion, RVB)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Në RVB thuhet: UMT-ja vazhdimisht ka në fokusin e vet krijimin dhe vënien në përdorim të teknologjisë në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, kjo falë dhe Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe IT të UMT. Prej vitesh, UMT ka vënë në dispozicion të procesit mësimor platformat digjitale (aktualisht edu4schools) nëpërmjet së cilës jo vetëm menaxhohen aspekte të ndryshme të mësimdhënies dhe testimit të njohurive, por module specifike përdoren për të mbështetur metodat inovative të mësimdhënies si krijimi i klasave virtuale, shkëmbimi i materialeve me studentët, ndërveprimi dhe komunikimi me studentët, përditësimi i ndërfaqes personale të pedagogut etj.</p> <p>GVJ e gjen të vërtetë këtë pohim dhe, në takimin me personelin akademik, u informua që si ngarkesa e tyre në auditor ashtu edhe ajo jashtë auditorit janë optimale dhe u lejon atyre përmbushjen e të gjitha objektivave të Programi i Studimit me Karakter Profesional 2-vjeçar në “Dizajn dhe Zhvillim Software”</p> <p>(Aneksi Nr. 35: Ndërfaqe classroom e një pedagogu; Aneksi Nr. 34: modeli i vlerësimit të performancës; pyetje nga vizita në Institucion, RVB)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të</p>	<p>Nga dokumentat që na vuri në dispozicion UMT (DVV) si dhe protokollin e vizitave në institucion, GVJ u informua për metodat dhe procedurat që ndiqen në këtë institucion me qëllim kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. Ai konstatoi që mënyrat e ndjekura janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -forume akademike, -promovime, të krijimeve dhe të botimeve të ndryshme,

<p>personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>-aktivitete përmblylëse të projekteve kërkimore/studimore, - prezantime të veçanta, simpoziume, -leksione te hapura, referime shkencore, -workshope, - shkolla verore -konferencat kombëtare/ndërkombëtare.</p> <p>Për t'u njohur me efincën e këtyre metodave, GVJ drejtoi pyetje gjatë takimit me stafin akademik.</p> <p>Tek pyetja: sa ju mbështet institucioni për kërkimin shkencor, një pedagog pohoi që universiteti ofron mobilitet me partnerët, ofron laboratorët e tij si dhe lidhje marrveshesh. Nga një analizë tërësore GVJ vlerëson që kriteri plotësohet, por ai do të sugjeronte një përfshirje edhe më të madhe në projekte për realizimin e doktoratave, natyrisht duke shfrytëzuar mundësitë për financimin, aktivizimin dhe zhvillimin e tyre.</p> <p>Në veçanti, stafi i ri akademik përfshihet në mësimdhënie nën përqasjen e lektorit mbështetës në mënyrë që të marrin një përkujdesje dhe drejtim profesional nga lektorë me eksperiencë.</p> <p>Në kuadrin e bashkëpunimeve ndërkombëtare është ngritur edhe Instituti Francez i Teknologjisë ku me mbështetjen e partnerëve të huaj synojnë rritjen profesionale dhe shtytjen e kërkimin shkencor në UMT. Ndër planet afatshkurtra është edhe hapja e një laboratorit mbi Inteligjencën Artificiale.</p> <p>Institucioni disponon një qendër inovacioni e cila është në shërbim të stafin akademik për kryerjen e eksperimenteve të ndryshme. Institucioni është partner në një projekt Erasmus+ për ngritjen e kapaciteteve dhe hapjen e një shkolle doktrale në bashkëpunim me vendet e rajonit (MARDS).</p> <p>Institucioni është partner në një projekt Evropian H2020 e quajtur Smart4All e cila nxit përdorimin e inteligjencës artificiale në shërbim të ekosistemin vendas.</p> <p>Pjesëtarët e FSHKIT janë aktivë në projekte Evropiane COST që nxisin rritjen e rrjetit akademik në Evropë.</p> <p>(Aneksi Nr. 36, Udhëzues për planin e mobilitetit për stafin akademik në kuadër të Erasmus+; RVB, Takimet në Institucion).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme</p>	<p>Bazuar në DVV, UMT siguron mjediset të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore në funksion të gjitha programeve të studimit që</p>

<p>mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>ofron. Vlerësimi i kapaciteteve pritëse zhvillohet në mënyrë periodike në vartësi të nevojave që ka çdo program studimi dhe projeksioneve që institucioni ka për përthithjen e studentëve në vitin e ri akademik. UMT kryen dhe zhvillon veprimtarinë akademike dhe administrative në 2 godina, të cilat janë në përdorim të institucionit dhe menaxhohen prej tij. Zyra e Financës është struktura që disponon inventarët e aseteve të institucionit si dhe planifikon dhe realizon, në përputhje me buxhetin e miratuar. sipas udhëzimeve përkatëse, shtimin dhe përmirësimin e tyre, sipas zërave konkretë. Godinat kryesore të institucionit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Godina 1 me 2347 m2 • Godina 2 me 2490 m2 <p>Mjediset në dispozicion të programit, janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një mbarëvajtje të procesit mësimor. Aktivitetet akademike në lidhje me programin e studimit zhvillohen në Godinë 2. Në këtë godinë gjenden salla për zhvillimin e leksioneve, salla seminaresh, gjithashtu 4 laboratore informatike dhe elektronike. Biblioteka ndodhet në Godinë 1 të institucionit. GVJ, gjatë vizitës në institucion, i vizitoi të gjitha këto ambiente dhe konstatoi që ato janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike duke marrë në konsideratë numrin e studentëve, grupet mësimore dhe natyrën specifike të programit të studimit e moduleve përkatëse. Mendojmë të sigurohet ambjenti i parkimit dhe ambienti relaksues, të cilat institucioni i ka adresuar në ndërtimin e kampusit të ri.</p> <p>(Aneksi Nr. 50: Raporti i GP për verifikimin e kapaciteteve pritëse; Aneksi Nr.37: Asetet Infrastrukturore, akademike UMT; Aneksi Nr. 39: Projekti Buxheti viti akademik 2021-2022; Aneksi 32: Lista e laboratorëve në funksion të programit të studimit; Vizita në Godinat e UMT, RVB)</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në UMT, GVJ vizitoi mjediset mësimore ku zhvillohej procesi për realizimin e Programi i Studimit me Karakter Profesional 2-vjeçar në “Dizajn dhe Zhvillim Software”</p> <p>GVJ konstatoi se të gjitha klasat janë të pajisura me kompjuter dhe video-projektor për të zhvilluar orën mësimore, dhe gjithashtu konstatoi që në funksion të lëndës, institucioni vë në dispozicion 3 laboratorë kompjuterike që janë të pajisur me software profesionalë, aksesime në literaturë, të cilat garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik.</p> <p>(Vizita në mjediset e UMT, RVB)</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, ateliet apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparatat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Gjatë vizitës në UMT, GVJ konstatoi që në shërbim të programit të studimit, laboratorët kompjuterike janë të pajisur me aplikacionet e nevojshme për simulime dhe zhvillim software si: CodeBlock, NetBeans, Eclipse, Octave, Apache, MySQL Workbench, etj.</p> <p>(Aneksi 32: Lista e laboratorëve në funksion të programit të studimit; Vizita në laboratorët e UMT, RVB)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit,</p>	<p>GVJ vizitoi 6 ambiente laboratorike ku 3 prej të cilave janë laboratorë kompjuterike të pajisur me software ku konkretisht studentët aftësohen me konceptet e sistemeve elektronike, sistemet e menaxhimit të të</p>

<p>të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>dhënave, rrjetat kompjuterike, sistemet softëare, etj. Pra, çdo student mund të ndjekë dhe të praktikojë njëkohësisht njohuritë e marra në lëndët përkatëse në lidhje me programet e mësipërme</p> <p>(Aneksi 32: Lista e laboratoreve në funksion të programit të studimit; Vizita ne laboratorët e UMT, RVB)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.</p>	<p>GVJ, mbështetur në RVB, dhe vizitën në institucion konstaton që UMT, garanton një numër të mjaftueshëm laboratoresh për kryerjen e aktiviteteve praktike dhe laboratorike.</p> <p>Krahas laboratorëve, institucioni ka në dispozicion Qendrën e Inovacionit për aktivitete apo eksperimente të një niveli më të specializuar, duke garantuar mjedise të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike Praktikantët mësimorë zhvillohen nëpër ambientet e kompanive apo institucione me të cilët universiteti ka marrëveshje paraprake.</p> <p>(Aneksi Nr. 12: Lista e marrëveshjeve në kuadër të programeve të studimit; Aneksi 32: Lista e laboratorëve në funksion të programit të studimit, Vizita në UMT, RVB)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
<p>Standardi IV.3</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij</p>				
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>			
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ vizitoi bibliotekën e “Universitetit Metropolitan Tirana”, e cila ofron kushte për akses të barabartë, e pa pagesë për të gjithë studentët. Biblioteka ishte e pajisur me PC, ku mundësohej përdorimi i literaturës në format elektronik pa kufizim nga studentët si dhe i programeve kompjuterike. Refeuar RVB, Rregullores së UMT, rregullores së bibliotekës dhe takimeve të zhvilluara, rezultojnë se:</p> <p>Biblioteka e UMT ofron shërbim falas për studentët, personelin mësimdhënës e administrativ, si dhe persona të tjerë, në përputhje me rregulloren e bibliotekës si me prezencë ashtu edhe online. Bazuar në rregulloren e UMT-së biblioteka shkencore e Universitetit është bibliotekë publike që mund të përdoret edhe nga lexues të tjerë. Ajo ka në fondin e saj, tekste mësimore bazë, cikle leksionesh, artikuj e botime të ndryshme si dhe libra e revista në gjuhën shqipe dhe të huaj që ju</p>			

	<p>vinë në ndihmë studentëve për të studiuar dhe hulumtuar.</p> <p>(Vizita ne biblioteken e UMT, RVB)</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e UMT-së, biblioteka shkencore e Universitetit është bibliotekë publike që mund të përdoret dhe nga lexues të tjerë. Biblioteka e UMT-së është e angazhuar për të siguruar përsosmëri në të gjitha fushat e ofrimit të shërbimit dhe shërbim falas për studentët, personelin mësimdhënës e administrativ. Universiteti “Metropolitan Tirana” ka vënë në dispozicion të studentëve të këtij programi tekste mësimore të hartuara nga pedagogë e tij, si dhe nga pedagogë më me emër të universiteteve të tjera në vend. Përpjekje paraprake janë bërë edhe për sigurimin e literaturës ndihmëse cilësore. Librat janë de facto në dispozicion dhe numri i kopjeve është i mjaftueshëm në raport me numrin e studentëve të regjistruar. Biblioteka e “Universitetit metropolitan Tirana” në fondin e saj numëron rreth 758 libra, si dhe një numër të konsiderueshëm revistash, cikle leksionesh, artikuj e botime të ndryshme.</p> <p>Sidoqoftë, duke konsideruar që procesi i botimeve e publikimeve të rezultateve të studimeve e të kërkimit shkencor është një proces tejet dinamik dhe me prurje të madhe në literaturë, mbetet detyrë e vazhdueshme e institucionit pasurimi në vijimësi i fondit të bibliotekës dhe zgjerimi i ambjenteve të saj. Mendojmë që të përmirësohet në vijimësi fondi i literaturës në hard copy dhe elektronike në gjuhën shqipe për programin profesional “Dizajn dhe Zhvillim Software.</p> <p>(Vizita në bibliotekën e UMT, RVB)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Universiteti “Metropolitan Tirana” ofron aplikacionin “edu4school”. Nëpërmjet këtij aplikacionit studentit i mundësohet akses në leksione dhe materialet e ndryshme didaktike që janë në përputhje me syllabuset e lëndëve të Universitetit dhe tekste bashkëkohore. Sipas rregullores së Bibliotekës, UMT-ja ju garanton të gjithë studentëve ku janë përfshirë edhe studentët e programit të studimit PrDZhS akses në të gjithë fondin e saj.</p> <p>Studentet konsultohen me leksionet në kohë reale. Ata kanë akses edhe në adresa online të cilat shfrytëzohen si biblioteka elektronike të tilla si:</p> <p>www.thefreelibrary.com</p> <p>www.gutenberg.org</p> <p>www.cobis.al</p> <p>www.reatprint.com etj</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua që UMT është në përfundim të lidhjes së marrëveshjes me RASH për akses në bibliotekën online: https://ulibrary.rash.al</p> <p>(Pyetje gjatë vizitës në UMT)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ kostaton se UMT, krahas marrëveshjeve të shumta që institucioni ka me kompanitë në kuadrin e</p>

<p>angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p>	<p>praktikave mësimore, si dhe vecanërisht për programin profesional "Dizajn dhe Zhvillim Software", UMT është pjesë e projektit "Cooperative Training for Better Employees in Tourism Management and Digitalization (CTBE-TMD)" e cila ka si qëllim ti mundësojë studentëve të këtij programi studimi zhvillim e praktikave mësimore pranë kompanive që janë partnere të projektit. Në këtë mënyrë, studentët, krahas njohurive teorike dhe praktike që ofron vetë institucioni, ka edhe përkrahjen e kompanive në vend për të pasuruar njohuritë e studentëve me teknologjitë më të reja në tregun e punës.</p> <p>(Aneksi Nr. 49: Projekti CTBE-TMD; Pyetje gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.</p>	<p>Nga vizitat ne UMT, vërehet që përgatitja e buxhetit vjetor kalon nëpër disa hapa, përpara miratimit përfundimtar nga ana e Bordit Administrativ. Çdo vit akademik, Rektorati i UMT iu kërkon fakulteteve, njësisive bazë dhe njësisive të tjera të Universitetit për aktivitetet e planifikuara që do të organizohen nga secila njësi gjatë vitit vijues akademik, duke qenë gjithmonë në përputhje me planin strategjik të Universitetit. Fakultetet, pasi mbledhin kërkesat e njësisive bazë, i përcjellin për miratim të mëtejshëm në Rektorat. Rektorati merr vendimin përkatës dhe ia dërgon propozimin për miratim përfundimtar Bordit i Administrimit të Universitetit.</p> <p>Pas miratimit të nevojave për burime njerëzore, infrastrukurore dhe aktivitete të planifikuara nga secila njësi, si dhe duke marrë në konsideratë të ardhurat dhe shpenzimet gjatë viteve të kaluara akademike, projektbuxheti institucional i universitetit përgatitet nga Administratori dhe zyra e financës dhe më pas miratohet nga Bordi i Administrimit.</p> <p>UMT harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të tij. Universiteti për sa i takon financimit dhe menaxhimit të burimeve financiare funksionon konfirmon legjislacionit në fuqi, që rregullon veprimtarinë e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Raporti financiar i hartuar nga zyra e Financës detajohet dhe paraqitet me zërat e kostove përkatëse për programet e studimit në rang fakulteti.</p> <p>(Aneksi Nr. 38: Raporti vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar; Aneksi Nr. 39: Projekt Buxheti për vitin akademik 2021-2022; Tabela 18: Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit)</p>			
<p>Kriteri 6. Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.</p>	<p>Bazuar dokumentacionin e vendosur në dispozicion. Dhe shqyrtimin e raporteve zyrtare financiare, GVJ, konstaton se, në raportet: Pasqyra e të Ardhurave dhe deklarata e Shpenzimeve e Institucionit, kompania ka një bilanc vjetor pozitiv dhe stabilitet financiar i cili garanton përparimin e institucionit.</p> <p>(Tabela 18: Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit; RVB)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kritere të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ konstaton se aktet rregullatore të UMT, politikave dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik, nga regjistrimi në universitet deri në diplomim, bazohen në Udhëzimet dhe urdhrat përkatës të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe rregulloret e Universitetit Metropolitan Tirana. Rregullorja e UMT dhe e FSHKIT përshkruan të gjitha politikave dhe procedurat në lidhje me programin e plotë të studimit të ciklit akademik, nga regjistrimi deri në diplomim. Aty përshkruhen kriteret dhe procedurat e regjistrimit, procesi arsimor dhe kriteret dhe procedurat e diplomimit. Universiteti Metropolitan Tirana pranon student bazuar në kuotat e pranimit dhe kriteret e përzgjedhjes të miratuara (vendimi i senatit për kuotat e pranimit 2020-201) dhe miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.</p> <p>(Aneksi Nr. 01: Statuti i UMT; Aneksi Nr. 02: Rregullore e Brendshme UMT; Aneksi Nr. 5: Rregullorja e FSHKIT ; Pyetje gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>UMT çdo vit, sipas edhe kërkesës së Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, komunikon kriteret e pranimit dhe kuotat për çdo program studimi. Kriteret bëhen publike si nga ana e UMT-së, ashtu edhe nga ana e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe IT në mënyrë direkte ose nëpërmjet sektorit të marketingut, i cili përdor mjete të ndryshme përveç web-it. Kriteret e veçanta që duhet të përmbushen nga ana e kandidatëve për tu pranuar në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e UMT-së.</p> <p>(Aneksi Nr. 40 - Procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në programet e UMT); RVB)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>Bazuar në DVV, nga GVJ, shikohet se kandidatët për të ndjekur studimet në programin profesional si dhe gjithë publiku, informohen përpara fillimit të çdo viti akademik në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike që kërkohen për tu regjistruar në këtë program studimi. E gjitha kjo bëhet sipas një plani të mirëmenadur dhe të konceptuar drejtë në mënyrë që kërkuesve të ju vihet në dispozicion sa më i saktë dhe i plotë.</p> <p>(Aneksi Nr. 18, Raport i MASR mbi certifikimin e kuotave të pranimit në UMT 2019-2020).</p>
<p>Kriteri 4. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve,</p>	<p>Programet Profesionale ofrohen me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, me 120 ECTS. Në ligjin nr. 80/2015 “për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor” (përcaktuar dhe në Statutin e UMT) jepet</p>

<p>mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>informacion mbi organizimin e programeve Profesionale me referencë niveli i 5stë i Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Në përfundim të studimeve studentit pajiset me diplomë të Programit Profesional sipas përcaktimeve në Statutin e UMT. Që në fillim të çdo viti akademik, bëhet i mundur informimi me studentët e çdo viti lidhur me strukturën e vitit akademik në të cilën detajohet kohëzgjatja e vitit akademik, ndarja e tij në semestra, si dhe periudha e provimeve.</p> <p>eduKonatatojme se studentit i jepet nje informacion i detajuar për: Programin profesional “Dizajn dhe zhvillim Software”, planin mësimor, organizimin ne semestra/vite, ngarkesën mësimore në auditor për çdo lëndë sipas formave të mësimdhënies etj., nëpërmjet faqes web të institucionit, informimit direkt me përgjegjësin e programit të studimit apo nëpërmjet postës elektronike në departament, zyrës së karrierës, dhe sistemit online. Edu4school.</p> <p>(Aneksi Nr. 1: Statuti UMT; Aneksi Nr. 9: Plani i Mesimor; Aneksi Nr. 41 – Të dhëna të përgjithshme mbi programin e studimit) ; Pyetje gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Në vizitën në UMT, shikojmë se në stendën e Fakultetit, janë varuara orari, struktura vitit akademik si dhe informacion për lëndët, ndarjet e tyre në semestra, kreditet, orari i mësimit, njoftime të ndryshme, pjesë të rëndësishme të rregullores, etj.</p> <p>Po ashtu, veprimtaritë formuese/trajtime janë të publikuara në faqen zyrtare të universitetit: https://umt.edu.al/ dhe në domain-in: @umt.edu.al, interesimit të drejtë përdrejtë të studentëve në Sekretarinë Mësimore, Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe asaj të Mbështetjes së Studentëve etj.</p> <p>Informacioni në lidhje me lëndët, mënyrat e vlerësimit etj., apo edhe rregulloret për programin e studimit, planet mësimore etj., jepet tek studentët në forma të cilat ato mund ti aksesojnë lehtësisht: ne hard-copy me anë të guidave, rregulloreve te posaçme, fletëpalosjeve, etj., të cilat gjenden në ambiente të FSHKIT-UMT dhe u vihen në dispozicion studenteve ne programet përkatëse, si dhe në formë digjitale si nëpërmjet sistemit online ashtu dhe komunikojë e-mail në lidhje me informacione të detajuara për leksionet e lendeve përkatëse, rastet studimore, detyrat e kursit e materiale të tjera.</p> <p>Nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta me studentët, njoftimeve në ambientet e FSHKIT, publikimeve në rrjet, studentët informohen dhe mbi vendimet e rëndësishme që lidhen me ta, të marra nga Senati Akademik, Dekanati etj.</p> <p>GVJ Konstaton se ka një sistem mirëinformues, për të gjithë procesin mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të Programi i Studimit Karakter Profesional 2-vjeçar në “Dizajn dhe Zhvillim Software”.</p> <p>(Nga Takimet gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>
<p>Kriteri 6. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>GVJ konstaton që sistemi i menaxhimit edu4schools funksionon për t'u dhënë studentëve saktë dhe në kohë të gjitha informacionet lidhur me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit, shërbimeve drejtuar studentëve, nga aplikimi në universitet, deri ne dhënieën e provimit të diplomës.</p>

	<p>UMT disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit interaktiv online, në të cilin regjistrohet dhe arkivohet i gjithë informacioni në lidhje me studentët nga momenti i regjistrimit deri në pajisjen me diplomën sipas ciklit përkatës.</p> <p>Ndërkohë që siç u tha më lart, në platformën GoToMeeting e cila është komplementare me sistemin Edu4School, menaxhohet aktiviteti mësimor online i studentëve ku u mundësohet ndjekja e mësimëve online apo të konsultojnë regjistrimet e bëra për orët e mësimit.</p> <p>(Aneksi Nr. 24– Shembuj nga përdorimi i Edu4School dhe GoToMeeting) ; Pyetje gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.</p>	<p>Sipas Organigramës, Universiteti “Metropolitan Tirana”, ka ngritur sistemin e kontrollit të brendshëm mbi bazën e parimeve të funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionon/operon mbi bazën e një strukturë të qartë dhe të mirë organizuar. Kompetencat dhe përgjegjësitë e secilit pozicion rregullohen në Statut, Rregulloren e brendshme, rregulloret e fakulteteve, departamenteve, zyrave, programeve studimore dhe rregulloret e tjera të UMT, si dhe në kontratën individuale dhe Job Description për çdo pozicion pune. UMT, disponon një sistem efektiv për menaxhimin e informacionit, i cili zhvillohet në dy linja, atë verbal e shkresor, dhe atë elektronik. Informacioni rrjedh në nivel horizontal dhe vertikal. Zyra e Informacionit dhe Zyra e Protokollit janë përgjegjëse për qarkullimin e informacionit verbal dhe shkresor në institucion. Mënyrë tjetër e shkëmbimit të informacionit që përdoret në UMT është dhe ajo e komunikimit të brendshëm nëpërmjet postës elektronike me domain me të cilin është pajisur i gjithë stafi akademik e administrativ, si dhe studentët. Grupi Vlerësimit të Jashtëm, Mendon se struktura organizative e UMT, siguron efikasitet dhe efikasitet.</p> <p>(Aneksi Nr. 4: Organigrama UMT; Takimet gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Në UMT, të gjitha metodat e përdorura për ruajtjen dhe shkëmbimin e informacionit menaxhohen dhe administrohen nga personi përgjegjës i sektorit të teknologjisë dhe informacionit në nivel rektorati dhe njësisë kryesore, të cilët janë njëkohësisht përgjegjës për sigurinë e informacionit dhe ruajtjen e tij në hard-copy në arkivin e UMT.</p> <p>Nëpërmjet bashkëpunimit me Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), UMT, realizon procesin e aplikimit online të kandidatëve (maturantë) në programet e UMT-së. Po ashtu, koordinohen të dhënat e</p>

	<p>studentëve për krijimin e regjistrimit elektronik themeltar, sipas udhëzimeve të MASR. UMT përdor shërbimet e Management System (AMS) për komunikimin me ASCAL nëpërmjet të cilit, administron dhe menaxhon të gjithë informacionin elektronik dhe arkivin elektronik që lidhet me të dhënat e institucionit, strukturën akademike, administrative dhe shërbimeve. Po kështu administrohen edhe dokumentacionet lidhur me licencimin dhe akreditimin e programeve të studimit dhe të dhënat e detajuara për to, studentët aktivë që ndjekin studimet, stafin akademik në kohë reale, fushën e studimit, kualifikimet dhe të dhëna të tjera të cilat përditësohen në kohë reale. Nëpërmjet këtij sistemi, UMT-ja aplikon për shërbime të ndryshme të kryera nga ASCAL-i, po ashtu, raporton në mënyrë të vazhdueshme në ASCAL në lidhje me aktivitete të zyrës së sigurimit të cilësisë apo raportime në lidhje me procese të vlerësimit që kryhen në UMT.</p> <p>GVJ mendon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>(Aneksi Nr. 02: Rregullore e Brendshme e UMT; Pyetje gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në faqen zyrtare https://umt.edu.al/ të UMT-së, qartazi duket shkëmbimi informacionit, ku dhe institucioni pasqyron veprimtarinë administrative, institucionale, akademike, kulturore e sociale që pasqyrohet në rubrika të veçanta (informacion lidhur me dokumentet kryesore të UMT-së (statut dhe rregullore, etj), vendime të SA (miratim strategjie, programe plane dhe kurikula mësimore, kriteresh, kuota, afate aplikimi regjistrimi të studentëve etj), ciklet dhe programet e studimit, organigramën e UMT-së, njoftime/thirrje për projekte, Revista shkencore, etj. I gjithë stafi dhe studentët kanë akses në përputhje me shkallën hierarkike dhe dispozitat ligjore lidhur me konfidencialitetin. Ata posedojnë adresë elektronike pjesë e domain: @umt.edu.al, me anë të së cilave mbahet komunikimi i përditshëm mes kolegëve, studentëve dhe të tretëve.</p> <p>(Aneksi Nr. 01: Statuti i UMT; Aneksi Nr. 2: Rregullore e Brendshme e UMT; Aneksi Nr. 42: Rregullore e arkivës); Takimet gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga vizita e GVJ në sekretari, konstatojmë se UMT, ka në përdorim sistemin e informacionit të sekretarisë on-line (SIS) dhe nga Portalin e Studentit, sistemi "Edu4Schools" ku ofrohen funksionalitete të nevojshme për ruajtjen dhe përpunimit e informacionit elektronik lidhur me procesin akademik konkretisht: programet (silabuset) e lëndëve, frekuentimi i studentëve, vlerësimi i arritjeve të studentit etj. Gjithashtu, këto sisteme ofrojnë çdo informacion tjetër akademik, procedural, financiar, njoftime etj., të aksesueshme nga studentët dhe stafi.</p> <p>(Aneksi Nr. 2: Rregullore e Brendshme e UMT; Aneksi Nr. 42: Rregullore e arkivës; Vizitat në UMT, RVB)</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Në UMT, me anë të sistemit Edu4School, menaxhohen të gjitha të dhënat e procesit akademik si psh: orët e realizuara, materialet didaktike, mungesat e studentëve etj. Nëpërmjet këtij sistemit Universiteti "Metropolitan Tirana", garanton monitorimi në kohë reale i të gjitha veprimtarive dhe aktivitetit akademik e administrative. Ky sistem mundëson raportime individuale dhe evidencë mbi të dhënat në kohë reale për strukturat, organet drejtuese dhe titullarët e UMT. Ky</p>

	<p>kriter permbushet plotësisht.</p> <p>(Aneksi Nr. 2: Rregullore e Brendshme e UMT; Aneksi Nr. 42: Rregullore e arkivës; Takimet në UMT, RVB)</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Në faqen online të Universitetit “Metropolitan Tirana” https://umt.edu.al/ publikohen të gjithë informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, dhe aktivitetet e ndryshme, në dy gjuhë ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p> <p>(Aneksi Nr. 2: Rregullore e Brendshme e UMT; Aneksi Nr. 30: Rregullore e Sekretarisë mësimore; RVB)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
<p>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ konstaton se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik, nga regjistrimi në universitet deri në diplomim, bazohen në Udhëzimet dhe urdhrat përkatës të MASR dhe rregulloret e Universitetit Metropolitan Tirana. Rregullorja e UMT dhe e FSHKIT përshkruan të gjitha politikat dhe procedurat në lidhje me programin profesional, nga regjistrimi deri në diplomim. Aty përshkruhen kriteret dhe procedurat e regjistrimit, procesi arsimor dhe kriteret dhe procedurat e përfundimit të programit profesional. Universiteti Metropolitan Tirana pranon student bazuar në kuotat e pranimit dhe kriteret e përzgjedhjes të miratuara (vendimi i senatit për kuotat e pranimit 2020-201) dhe miratuar nga MASR.</p> <p>Në formë periodike institucioni analizon kapacitet infrastrukturorë. Institucioni kujdeset që nga regjistrimi i studentëve dhe pajisja e tyre me numër matrikullimi, krijimi i dosjes së plotë të studentit dhe deri në dalje duke u kujdesur për diplomimin dhe suplementin e diplomës</p> <p>Kuotat si dhe kriteret e pranimit propozohen nga departamenti duke pasur parasysh kapacitet infrastrukturorë që disponon institucioni në përgjithësi dhe kapaciteteve akademike që disponon departamenti në veçanti.</p> <p>GVJ kërkoi disa dosje studentësh (random) dhe konstatoi se ishin në përputhje me kërkesat ligjore.</p>

	<p>(Aneksi Nr. 1: Statuti i UMT; Aneksi Nr. 2: Rregullore e Brendshme UMT; Aneksi Nr. 5: Rregullorja e FSHKIT; Aneksi Nr. 50: Raporti i GP për verifikimin e kapaciteteve pritëse; Aneksi Nr. 16: Kriteret e pranimit 2021-2022; Aneksi Nr. 17: Kuotat e pranimit 2021-2022; RVB)</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konsultoi dokumentacionin e administrimit, procedurat, rregulloret etj, të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të universitetit. UMT i referohet urdhrin të Ministrin të Arsimit, Sportit dhe Rinisë në lidhje me procedurat e regjistrimeve të studimeve të ciklit të parë të studimit.</p> <p>Kandidatët aplikojnë me anë të portalit E-Albania (sipas udhëzimit të MASR)</p> <p>Komisioni ad hoc (i ngritur për këtë qëllim me antarësi të stafit të departamentit) shqyrton listën e aplikantëve në përputhje me kriteret dhe kuotat e miratuara dhe propozon listën paraprake të fituesve Shpallet lista e kandidatëve fitues pas miratimit të nga komisioni i posaçëm</p> <p>Kandidatët kryejnë regjistrimin përfundimtar në programin e studimit ku janë shpallur fitues</p> <p>Rregullorja e FSHKIT dhe UMT përmban në mënyre të detajuar procedurat dhe praktikat e trajtimit të studenteve që nga momenti i regjistrimit deri në përfundim të studimeve, gjë që garanton politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë kandidatet dhe studentet e programit.</p> <p>(Aneksi Nr. 1: Statuti i UMT; Aneksi Nr. 2: Rregullore e Brendshme UMT; Aneksi Nr. 5: Rregullorja FSHKIT; Aneksi Nr. 44: - Procesverbal i Komisionit të pranimit të maturantve me përlllogaritjen e pikëve dhe rankimin e kandidatëve; Pyetje gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i ofruar si dhe nga takimi me studentët, GVJ mësoi që ata i njihnin dhe njëkohësisht për ta ishin të aksesueshme kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit</p> <p>Kriteret e pranimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve në programin PrDZHS miratohen çdo vit akademik nga Senati Akademik dhe bashkë me kuotat i përcillen MASR. Aktualisht, kriteret për programin PrDZHS janë vetëm sipas VKMsë në fuqi.</p> <p>(Aneksi Nr. 50: Raporti i GP për verifikimin e kapaciteteve pritëse) ; Aneksi Nr. 40 - Procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në programet e UMT; Pyetje gjatë takimit me studentët në UMT, RVB)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Gjatë vizitës në UMT, GVJ konstatoi se Zyra e Karrierës dhe Alumni në bashkëpunim me FSHKIT organizon takime për planifikimin e karrierës për studentët e ciklit të parë të UMT dhe për student të universiteteve të tjera të fushës së shkencave aplikative.</p> <p>Nga takimi me studentët, GVJ mësoi që ata kishin informacion të detajuar për universitetin në përgjithësi dhe për programet e ciklit: Programi i Studimit me Karakter Profesional 2-vjeçar në “Dizajn dhe Zhvillim Software”.</p> <p>Pas marrjes së informacionit të përgjithshëm nga Zyra e Karrierës, aplikantët merrnin një informacion më të detajuar nga stafi akademik i programit të studimit.</p> <p>(Takimet në Zyrën e Karrierës, gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>

<p>Kriteri 5. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në javën e parë të vitit të dytë, departamenti informon studentet që ndjekin programin PrDZhS, me takime orientuese me studentët, përmes standave të tij. Kreu VII i Rregullores së UMT përcaktohen qartë kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës.</p> <p>(Aneksi Nr. 02 - Rregullore e Brendshme UMT; Pyetje gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>			
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se përpara fillimit të çdo viti akademik, zyra e Karrierës dhe Alumni organizon takime të hapura për planifikimin e karrierës dhe për të diplomuarit të UMT. Në programin e përmendur, studentët e mundshëm janë të ftuar në Universitetin Metropolitan Tirana, Gjithashtu GVJ konstaton se studentët, marrin informacion të detajuar për universitetin dhe programin PrDZhS të studimit. Pranimi në programin profesional është i mundur për çdo kandidat që ka mbaruar studimet e ciklit para-universitar në vend apo në ndonjë shtet të huaj diplomë e të cilave njihet nga ministria e arsimit, si dhe kriteret e miratuara çdo vit akademik.</p> <p>Informimi në këtë drejtim bëhet online nëpërmjet faqes zyrtare UMT, në rrjetet sociale, si dhe fizikisht në ambientet e FSHKIT. Organizoheshin takimeve mbi këtë program studimi, kryesisht në ambientet e FSHKIT por edhe në panairt e organizuara nëpër qytete mbi këshillimin e karrierës. Gjatë takimeve përdoren edhe materiale promovues të ndryshme.</p> <p>GVJ kërkoi disa dosje studentësh (random) dhe konstatoi se ishin në përputhje me kërkesat ligjore.</p> <p>(Takime me studentet si dhe pyetje gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Standardi V.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.</p>	<p>GVJ konstaton se aktet rregullatore të UMT parashikojnë informacion të detajuar lidhur me procedurat gjatë studimeve.</p> <p>Në fazën e rekrutimit Zyra e Karrierës dhe Alumni në bashkëpunim me FSHKIT organizon takime për planifikimin e karrierës për studentët programit profesional të UMT.</p> <p>Në fillim të vitit akademik organizohet “Dita e orientimit” në të cilën studentët informohen mbi strukturën organizative të universitetit dhe shërbimeve që ofron çdo zyrë. Studenti prezantohet me programin e studimit, lëndët që ofrohen, stafin akademik si dhe përgjegjësin e programit që do shërbejë edhe si këshilltar akademik.</p> <p>Përgjegjësi i programit të studimit organizon takime periodike me studentët për të diskutuar mbi problematikat e ndryshme që mund të lindin gjatë vitit akademik si dhe i këshillon mbi ecurinë e karrierës së tyre akademike.</p> <p>Informacion i plotë dhe i përditësuar për strukturën institucionale dhe</p>

	<p>programet e studimit mundësohen nga faqja zyrtare e universitetit si dhe nga mediat sociale (Facebook, Twitter, LinkedIn, etj).</p> <p>UMT përdor platformën mësimore Edu4school ku studentet marrin informacionin e plotë për gjithë zhvillimin e procesit mësimor, mungesat, materialet didaktike, leksionet, rezultatet e kontrolleve, etj.</p> <p>(Pyetje dhe takimet gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Nga vizitat GVJ në sekretarinë mësimore, dosjet personale të studentit ruhen e menaxhohen nga sekretaria mësimore. Në këto dosje gjenden informacione mbi adresat, e-maillet dhe numrat e telefonit të studentëve të UMT-së, që janë të përfshirë në formë elektronike në databazat e fakultetit. Pjesë e sistemit të informimit janë edhe kriteret dhe procedura e transferimeve drejt programeve të studimit që ofron FSHKIT/UMT. Secili student i Universitetit Metropolitan Tirana dhe Alumni ka të drejtë të jetë pjesë e çdo lloj veprimtarie të organizuar nga Zyra e Karrierës dhe Alumni. Çdo student që merr pjesë në ndonjë aktivitet të zhvillimit të karrierës duhet së pari të regjistrohet pranë zyrës përkatëse.</p> <p>Zyra e Karrierës dhe Alumni në bashkëpunim me departamentet informon studentët për praktikën dhe mundësitë e punësimit në kompanitë/institucionet më të cilat janë lidhur marrëveshjet përkatëse. Na u vun në dispozicion materiale, të ekspozuara në Panairin e Karrierës i cili organizohet çdo vit.</p> <p>(Aneksi Nr. 46 - Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Karrierës UMT; Aneksi Nr. 12 - Lista e kompanive me të cilët institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi; Aneksi Nr. 45: Rregullore e Praktikave mësimore; Pyetje gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>
<p>Kriteri 3. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstaton që sistemi i menaxhimit edu4schools funksionon për t'u dhënë studentëve saktë dhe në kohë, një informacion të gjerë dhe të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të programit PrDZhS.</p> <p>Mundësi të tjera, jepen nga përdorimi i faqes zyrtare të UMT, komunikimet zyrtare në domain-in @umt.edu.al, interesimit të drejtë përdrejtë të studentëve në Sekretarinë Mësimore, Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe asaj të Mbështetjes së Studentëve, qoftë dhe nga përgjegjësit e programeve, departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, botimet e ndryshme dhe komunikimet verbale.</p> <p>(Takime në sekretarinë mësimore , takime me studentet gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>
<p>Kriteri 4. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nga vizita e GVJ në UMT, konstatohet që UMT disponon platformën Edu4School, një sistem të brendshëm të menaxhimit interaktiv online, në të cilin regjistrohet dhe arkivohet i gjithë informacioni në lidhje me studentët nga momenti i regjistrimit deri në pajisjen me diplomë. Informacioni në lidhje me procesin mësimor bëhet lehtësisht i aksesueshem përmes tij. Sistemi Edu4School i mundëson studentit të marrë informacion të nevojshëm edhe në distancë.</p> <p>Ndërkohë që në platformën GoToMeeting e cila është komplementare me sistemin Edu4School, menaxhohet aktiviteti mësimor online i studentëve ku u mundësohet edhe ndjekja e mësimave në distancë.</p> <p>(Aneksi Nr. 25: Shembuj nga përdorimi i Edu4School dhe GoToMeeting;</p>

	Pyetje gjatë vizitës në UMT, RVB)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimitë e diplomimit, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.	<p>GVJ vizitoi zyrën e Protokoll-Arkives, dhe sekretarëve Mësimore, nga ku konstaton, se në UMT ka një dokumentacion të plotë të dosjeve me të dhënat e studentëve që nga momenti i regjistrimit deri te diplomimi i tyre, i cili ruhet në formë të printuar, elektronike ose edhe në regjistra të plotësuar me dorë (zyrën e sekretarisë mësimore). Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit. Mendojmë që duhet në vazhdimësi një marketim më i gjerë i programit të studimit dhe përthithja e një numri më të lartë të studentëve.</p> <p>(Vizitë në zyrën e Protokoll Arshivës në UMT, RVB)</p>
Kriteri 2. Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<p>GVJ vizitoi Sekretarinë Mësimore, ku pjesë e arkivës është dokumentacioni që lidhet me rregulloret e programeve të studimit, ngarkesën mësimore të pedagogëve, marrëveshjet vjetore të stafit akademik, dokumentacion provimesh, punime diplomash të studentëve, të dhëna të aktivitetit shkencor, raporte analize dhe çdo dokumentacion që gjykohet i rëndësishëm në dokumentimin dhe sigurimin e cilësisë së veprimtarisë akademike të njësisë. Pjesë e dokumentacionit janë po ashtu dhe dosjet e stafit akademik, kualifikimet e tyre në vite, aktiviteti shkencor si dhe vlerësimet periodike të performancës.</p> <p>Në bazë të akteve normative, studentët kanë të drejtën e tërheqjes së dosjes individuale, por duke lënë në arkivë një kopje të saj, të sigluar nga personi dhe arkiva.</p> <p>Çdo vit akademik Sekretaria Mësimore raporton numrin e studentëve aktualë dhe të diplomuar të paktën katër herë si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të dhënat e raportit vjetor 2. Raport për student të regjistruar për herë të parë, në proces dhe të diplomuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në kuadër të certifikimit të kuotave të pranimit për vitin pasardhës akademik. 3. Lista e studentëve të regjistruar për herë të parë për pajisje me NIM dhe të diplomuar e cila përcillet çdo vit akademik në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA) 4. Të dhëna statistikore të brendshme për të përfunduar procedura të ndryshme të brendshme. <p>(Aneksi Nr. 30 – Rregullore e Sekretarisë Mësimore; Takime në</p>

	Sekretarinë Mësimore gjatë vizitës në UMT, RVB)		
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.	<p>GVJ kontrolloi Dokumentacionin në Sekretarinë mësimore, nga ku rezulton se, duke filluar nga semestri i parë deri në diplomim, çdo notë (vlerësimi përfundimtar i lëndës) regjistrohet në formatin fizik (Regjistri i notave) dhe në sistem Edu4school, nga ku merret informacion i qartë dhe në kohë reale (nga sistemi) mbi përparimin e studentëve dhe performancën e tyre. Për secilin student, sistemi llogarit mesataren e tyre të bazuar në semestër dhe mesataren e tyre të mbledhur e cila jep informacion të plotë dhe të detajuar mbi performancën e tyre të përgjithshme.</p> <p>(Aneksi Nr. 30 – Rregullore e Sekretarisë Mësimore; Takimet në sekretarinë Mësimore dhe Pyetje gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>		
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	<p>Institucioni administron, ruan dhe arkivon të dhëna personale për studentet. Informacionet ruhen sipas legjislacionit në fuqi duke ruajtur sigurinë e tyre. Ato mund të merren nga persona të autorizuar me anë të kërkesës me shkrim në përputhje me legjislacionin në fuqi. Studentët mund të marrin të dhëna për ecurinë e tyre nëpërmjet llogarive personale të tyre.</p> <p>Të gjitha informacionet e studentëve të disponueshme në dokumente janë të regjistruara në Sistemin e brendshëm të UMT Edu4school. Informacioni në sistem ruhet në mënyrë të centralizuar dhe sigurohet duke deleguar përgjegjësitë përkatëse në zyrën përkatëse. Të gjithë përdoruesit kanë akses në raportet e tyre të personalizuar sipas roleve të tyre dhe njësive përkatëse. Sistemi Interaktiv pajis njësitë përkatëse me informacion të ri dhe të përditësuar që mund të përdoret për të përgatitur të dhëna të ndryshme statistikore në lidhje me informacionin e studentëve dhe performancën akademike.</p> <p>(Takimet gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>		
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>Konstatojmë se Institucioni harton raporte analitike, me të dhënat mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve. Zyra e Karrierës dhe Alumni është njësia përgjegjëse për të plotësuar bazën e të dhënave të saktë dhe të plotë të studentëve të diplomuar lidhur me punësimin e tyre. Zyra e Karrierës dhe Alumni zhvillon çdo vit takim me studentët të diplomuar, në të cilat zhvillohet dhe pyetësori me ta. Rezultatet e përpunuara shërbejnë në drejtim të përmirësimit të treguesve, lidhur me shkallën e cilësisë në UMT.</p> <p>(Takimet gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Përfaqësimi i studentëve në nivelet e vendimmarrjes dhe administrimit të UMT, është garantuar në Statut dhe aktet rregullatorë të institucionit, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Statutin e Universitetit Metropolitan Tirana.</p> <p>Studentët janë të përfaqësuar në organet vendimmarrëse dhe organe të tjera në Universitetin Metropolitan përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur në: Senatit Akademik dhe në Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Gjithashtu, studentët janë pjesë e grupeve të vlerësimit të brendshëm institucional dhe të programeve të studimit që ofron UMT. Duke u nxitur të marrin pjesë në jetën universitare dhe duke integruar sugjerimet e tyre në veprimtarinë e përditshme të institucionit.</p> <p>(Takime me studentet dhe Pyetje gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ konstaton se studentët përfaqësohen drejtpërdrejtë në organet vendimmarrëse dhe organe tjera në Universitetin Metropolitan përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur. Gjithashtu edhe Modalitetet për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Studentor, janë në përputhje me Statutin e UMT.</p> <p>Përmes përfaqësuesve të studentëve të zgjedhur në Senatit Akademik, Njësinë e Sigurimit të Brendshme të Cilësisë si dhe pjesëmarrjen aktive të këtyre përfaqësuesve në mbledhjet e këtyre organeve, bëhet e mundur që përfshirja e përfaqësuesve të studentëve në vendimmarrje të çështjeve që i përkasin procesit akademik dhe vlerësimit të tij, të jetë realist, specifik, produktiv.</p> <p>Meqenëse përfaqësuesit e këshillit studentor janë anëtarë të Senatit Akademik dhe NJSBC-së problemet e tyre adresohen drejtpërdrejt në bordin përkatës. Rezultatet janë të dukshme për studentët.</p> <p>Studentët e UMT kanë organizmin e vet, Këshillin Studentor, i ngritur sipas kuadrit ligjor për arsimin e lartë (LAL 80/2015) i cili funksionon bazuar në rregulloren e tij. Këshilli studentor zhvillon veprimtarinë e tij në funksion përmirësimit të jetës studentore si nga ana akademike, ashtu dhe sociale e personale të studentëve.</p> <p>(Aneksi Nr. 1: Statuti UMT; Aneksi Nr. 22. Rregullore e Këshillit Studentor; Aneksi Nr. 47: Aktet për përfshirjen e studentëve në organet kolegjiale të UMT; Takime me studentët gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjeshme të mëparshme.</p>	<p>Sipas Statutit të Universitetit Metropolitan Tirana, programet e studimit profesional, përmbajnë 120 kredite evropiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike/4 semestra. Ngarkesa akademike për studentët e ciklit të parë të studimeve në programin profesional PrDZhS për çdo semestër është 60 ECTS.</p> <p>Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit institucioni merr në konsideratë ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe sigurimin e procedurave jo-burokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e programeve të tyre të plota ose të pjeshme të studimit.</p> <p>Në dokumentin "Procedura e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në programet e UMT" përcaktohen saktë procedurat dhe parimet e njohjes së studimeve të mëparshme të plota ose të pjeshëm të studentëve, në</p>

	<p>përputhje me aktet rregullative të nxjerra nga MASR. Studentët që aplikojnë për transferim studimesh pranë UMT, dorëzojnë dokumentacionin përkatës pranë Sekretarisë Mësimore. Aplikimet shqyrtohen nga Komisionet e ekuivalentimit të ngritura nga dekani. Pas vlerësimit dhe ekuivalentimit, Komisioni i përcjell pranë Rektoratit për miratim përfundimtar.</p> <p>(Aneksi Nr. 40 - Procedura e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në programet e UMT; Takime gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Për të garantuar përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit Institucioni organizon pyetësorë, periodikisht çdo fund semestri, para provimeve përfundimtarë të lëndëve.</p> <p>GVJ verifikoi disa nga anketimet e bëra, dhe shqyrtoi disa prej tyre, duke konstatuar se Studentët inkurajohen të plotësojnë Pyetësorin për vlerësimin e lëndës, si një element i rëndësishëm që përdoret për përmirësimin e veprimtarive mësimore.</p> <p>GVJ gjithashtu konstaton se anketimet dhe pyetësorët, organizohen dy here në vit para provimeve.</p> <p>Koordinatori i Programit i emëruar nga Dekani pret komentet e studentëve për çështje të ndryshme në lidhje me programin e studimit në funksion të përmirësimit të tij.</p> <p>(Aneksi Nr. 24: Model i pyetësorit për studentët; Pyetje gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Sipas Statutit të UMT, studentëve u ofrohet informacion mbi procedurën dhe kriteret e vlerësimit të dijeve në lëndë të ndryshme të programit të studimit. Këtu përfshihet forma e vlerësimit, sistemi i vlerësimit, forma e kontrollit të dijeve, të drejtën për të marrë pjesë në provim, sezonin e provimit, datat e provimit, komisionet e provimit, zhvillimin e provimit, rezultatet e provimit, ankimimin dhe përmirësimin e notës.</p> <p>Bazuar në Statutin e Universitetit përfaqësuesi i studentëve për çështje të sigurimit të cilësisë është anëtar i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Gjithashtu, presidenti i Këshillit Studentor është anëtar të Senatit Akademik i cili është organi më i lartë vendimmarrës akademik në universitet. Anëtarët e Këshillit Studentor që përfaqësojnë komunitetin studentor kanë të njëjtën të drejtë vote dhe të shprehin shqetësime si të gjithë anëtarët e tjerë të organeve të lart përmendura. Përmes seanceve informuese të organizuara nga Zyra e Kurrikulës dhe Cilësisë studentët gjithashtu inkurajohen të plotësojnë Pyetësorët për studentët, të cilët konsiderohen si element të rëndësishëm në funksion të përmirësimit të veprimtarive mësimore, dhe aspekteve të tjera të jetës akademike studentore.</p> <p>Koordinatori i programit i emëruar nga Dekani ofron shërbim këshillimi për studentët, ndjek përparimin e tyre dhe i ndihmon ata në zgjidhjen e çështjeve që lidhen me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies të programit.</p> <p>(Aneksi Nr. 48: Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit; Aneksi Nr. 43: Detyrat e koordinatorit të programit; Aneksi Nr. 26: Rregullorja e provimeve, Aneksi Nr.24: Model i pyetësorit për studentët; Nga Takimet gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet Përbushet Përbushet</p>

				X

Standardi V.5

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>UMT ka një sistem të organizuar informacioni për të transmetuar te studentët të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, etj. Informacioni i nevojshëm publikohet në disa forma, në formën e guidave, rregulloreve, procedurave, të cilat ndodhen në dosjen e vetëvlerësimit. Sekretaria Mësimore ndjek jetën akademike të studentëve nga regjistrimi deri në diplomim, mban të dhëna dhe evidenca sipas akteve rregullative të UMT. Studentët ndihmohen në procedurat që duhet të ndjekin sipas rregulloreve, në mënyrë që të jenë sa më të lehta dhe zyra sigurohet që secila prej tyre të jetë e qartë për studentët. I gjithë informacioni për studentët është i hapur dhe udhëzimi ofrohet vazhdimisht ballë për ballë duke u siguruar që rregulloret dhe udhëzimet të jenë kuptuar mirë dhe qartë nga studentët.</p> <p>GVJ konstaton se UMT-ja ka njësi dhe struktura të posaçme që kanë si detyrë të informojnë dhe të kujdesen për studentët gjatë të gjithë vitit shkollor. Organet që janë të ngarkuara për këtë qëllim në UMT, janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zyra e informimit dhe e këshillimit të karrierës, e cila merret me informimin e studentëve që nga moment i ardhjes së tyre dhe gjatë të gjithë periudhës së shkollimit; • Zyra e shërbimit ndaj studentit, e cila është e ngarkuar të informojë studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të ndjekë shqetësimet e tyre dhe brenda afateve të përcaktuara ajo ju kthen përgjigje studentëve për kërkesat dhe shqetësimet e tyre duke synuar në zgjidhjen e tyre. • Këshilltarët akademikë japin informacione më të detajuara rreth zhvillimit të procesit mësimor dhe nevojave të tjera të studentëve. <p>Këshilltarët akademik japin informacione më të detajuara rreth zhvillimit të procesit mësimor dhe nevojave të tjera të studentëve.</p> <p>(Aneksi Nr. 4: Organigrama UMT; Nga takimet dhe Pyetje gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>
<p>Kriteri 2. Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e</p>	<p>GVJ konstaton se çdo student pajiset me një adresë elektronike personale. Me të njëjtën adresë email-i, studentët mund të hyjnë në Sistemin Edu4school. Në javën e parë të çdo viti akademik Zyra e Karrieres dhe Alumnit në bashkëpunim me Fakultetet organizon Ditët e Orientimit për studentët e vitit të parë. Gjatë seancave të orientimit, studentët e rinj (kryesisht për studentët që vijnë jashtë UMT) pajisen</p>

studimit.	<p>me informacion mbi çështjet administrative nga zyrat kryesore administrative të Universitetit dhe me informacion mbi çështjet akademike nga Fakultetet.</p> <p>(Nga takimet me studentet dhe Pyetje gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>		
<p>Kriteri 3. Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>UMT ofron shërbimin e këshillimit të karrierës nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës.</p> <p>Nga kjo zyrë merren informacione në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p>Zyra analizon kompanitë e suksesshme në vend për të përcaktuar kualifikimet e fuqisë punëtore të kërkuara dhe për të organizuar seminare, kurse, konferenca në mënyrë që të përgatisë studentët tanë. Përgjegjësitë e Zyrës së Karrierës dhe Alumni gjithashtu përfshijnë kryerjen e aktiviteteve të nevojshme për krijimin e mundësive për aktivizimin e potencialeve të studentëve duke i prezantuar ata me standardet dhe kushtet me të cilat ka të ngjarë të përballen në përpjekjen e tyre për të gjetur një vend pune; u siguron atyre informacionin e nevojshëm që mund t'i ndihmojë ata në karrierën e tyre të ardhshme; prezantimin e studentëve të diplomuar në botën e biznesit; dhe njohja e tyre me mjedisin e punës dhe duke u ofruar atyre mundësi trajnimi.</p> <p>Zyra e Karrierës dhe Alumni u ofron studentëve një gamë shërbimesh që mund t'i ndihmojnë ata të identifikojnë tiparet dhe interesat e tyre personale, të mësojnë rreth opsioneve të karrierës, të marrin përvoja praktike dhe të përgatiten për hapat e tyre të ardhshëm pas përfundimit të studimeve në UMT. Zyra krijon bashkëveprim midis studentëve universitare, studentëve të diplomuar dhe punëdhënësve /organizatave / institucioneve për të ndihmuar studentët të përmbushin objektivat e tyre personale dhe profesionale.</p> <p>(Aneksi Nr.46 - Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Karrierës UMT; vizita GVJ në UMT, RVB)</p>		
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.</p>	<p>Zyra e Karrierës dhe Alumni është njësia përgjegjëse për të siguruar një bazë të dhënash të saktë dhe të plotë të studentëve të diplomuar. Kjo zyrë ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon dhe ruan të dhënat për llojin dhe cilësinë e punësimit të programit të studimit dhe vënien e tyre në dispozicion të studentëve, organeve përkatëse dhe autoriteteve.</p> <p>(Aneksi Nr.46 - Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Karrierës UMT; Vizitat dhe Takimet e GVJ gjatë vizitës në UMT, RVB)</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	-------------------------------------	------------------------------------	--

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional
“Dizajn dhe Zhvillim Software” të Institucionit të Arsimit të Lartë
“Universiteti Metropolitan Tirana”

Pikat e forta dhe afirmime


1. Staf akademik i kualifikuar dhe i motivuar në përçimin e dijeve.
2. Numër relativisht i lartë i marrëveshjeve institucionale si për aktivitetet didaktike ashtu edhe për projekte kërkimore-shkencore.
3. Numër i konsiderueshem në projekte ndërkombëtare dhe shkëmbime stafi për avancimin akademik.
4. Ofrimi i lëndëve teorike dhe praktike në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.
5. Infrastruktura e disponueshme, ambiente dhe pajisjet laboratorike për zhvillimin e procesit mësimor.
6. Programi i studimit është në përputhje me një treg pune me hapësirë punësimi në vend dhe jashtë vendit.
7. Programi zhvillohet në një institucion të orientuar dhe angazhuar drejt cilësisë, dijes, përgatitjes profesionale dhe vlerave.
8. Programi studimit ka plane mësimore dhe syllabuse bashkëkohorë.
9. Lidhjet me kompanitë e teknologjisë se informacionit. Kjo i ndihmon studentët në përgatitjen e punimit të diplomës si dhe gjetjen e praktikave profesionale dhe mundësi për punësim.
10. Pajisja e studentëve me mjetet teknologjike (laptop) te pajisur me programe softuerike duke i kthyer mësimet më produktive dhe ndërvepruese.

Pika të dobta

1. Përmirësimi në vijimësi i fondit të literaturës në hard copy dhe elektronike në gjuhën shqipe për programin profesional “Dizajn dhe Zhvillim Software”. (Standarti IV.3, kriteri 2.)
2. Sigurimin e ambjenteve të parkimit dhe atyre relaksuese, të cilat institucioni i ka adresuar në ndërtimin e kampusit të ri. (Standarti IV.2, kriteri 1.)
3. Marketim më i gjerë i programit të studimit dhe përthithja e një numri më të lartë të studentëve. (Standarti V.3, kriteri 1.)

Rekomandime

1. Të rriten përpjekjet për kualifikimin e stafit akademik me grada dhe tituj shkencor (me programet e doktoraturës, etj.)
2. Shtim të kapaciteteve të bibliotekës në hapësira për studim, infrastrukturë kompjuterike si edhe në literaturë të viteve të fundit, sipas fushës së programit të studimit.



3. Avancimin e shpejtë me kampusin e ri me qëllim sigurimin e ambienteve të parkimit dhe atyre relaksuese.

Conclusions of the Evaluation of the professional study program "Software Design and Development" of the Institution of Higher Education "University Metropolitan Tirana"

Strengths and Affirmations

1. Qualified and motivated academic staff in imparting knowledge.
2. Relatively high number of institutional agreements for both didactic activities and research-scientific projects.
3. Considerable number of international projects and staff exchanges for academic advancement.
4. Providing theoretical and practical subjects in accordance with the needs and demands of the labor market.
5. Available infrastructure, premises and laboratory equipment for the development of the teaching process.
6. The study program is compatible with a labor market with employment space in the country and abroad.
7. The program takes place in an institution oriented and committed to quality, knowledge, professional preparation and values.
8. The study program has contemporary lesson plans and syllabuses.
9. Links with information technology companies. This helps students in preparing their thesis as well as finding professional internships and employment opportunities.
10. Equipping students with technological tools (laptops) equipped with software programs, making lessons more productive and interactive.

Weak points

1. Continuous improvement of the hard copy and electronic literature fund in the Albanian language for the "Software Design and Development" professional program. **(Standard IV.3, criterion 2.)**
2. Provision of parking and relaxation areas, which the institution has addressed in the construction of the new campus. **(Standard IV.2, criterion 1.)**
3. Wider marketing of the study program and absorption of a higher number of students. **(Standard V.3, criterion 1.)**

Recommendation

1. Increase efforts to qualify academic staff with scientific degrees and titles (with doctoral programs, etc.)
2. Increase of the library's capacities in spaces for study, computer infrastructure as well as in literature of recent years, according to the field of the study program.
3. Rapid progress with the new campus in order to provide parking and relaxation areas

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

